



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.96

26 korrik

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.45, datë 15.7.2010	Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për hetimin e fakteve, rrethanave dhe përgjegjësive të masakrës së Tivarit, 1945	5103
Vendim i Kuvendit nr.46, datë 15.7.2010	Për mosdhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Vexhi Muçmataj anëtar i Gjykatës së Lartë	5104
Dekret nr.6558 datë 13.5.2010	Për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese	5104
Dekret nr.6559 datë 13.5.2010	Për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese	5105
Dekret nr.6579 datë 25.5.2010	Për emërimin e anëtarit të Gjykatës së Lartë	5105
Vendim i KM nr.465, datë 2.6.2010	Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Spitalit Ushtarak Qendror Universitar”	5106
Vendim i KM nr.467, datë 16.6.2010	Për miratimin e protokollit të bisedimeve për bashkëpunimin për zhvillim, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për vitin 2010	5120
Vendim i KM nr.468, datë 16.6.2010	Për kalimin e një sipërfaqeje truall, pronë shtetërore, në fondin e kompensimit fizik dhe kompensimin e kishës ortodokse autoqefale, dioqeza Korçë, si dhe për një ndryshim në vendimin nr.1532, datë 19.11.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Korçë, të qarkut të Korçës”	5130

Vendim i KM nr.490, datë 23.6.2010	Për hapjen e programeve të reja të studimeve, në shkollën e lartë universitare private “Luarasi”, Tiranë	5133
Vendim i KM nr.491, datë 23.6.2010	Për licencimin e shkollës së lartë private “Universiteti Elite”, Tiranë	5134

VENDIM
Nr.45, datë 15.7.2010

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR HETIMIN E FAKTEVE,
RRETHANAVE DHE PËRGJEGJËSIVE TË MASAKRËS SË TIVARIT, 1945**

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 8891 datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore”, si dhe të neneve 25 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet komisioni hetimor i Kuvendit për hetimin e fakteve, rrethanave dhe përgjegjësi të masakrës së Tivarit të vitit 1945.

II. Objekti i punës së komisionit hetimor është:

a) hetimi për zbardhjen e plotë të ngjarjeve dhe përgjegjësi të individëve, ideatorëve, ekzekutuesve, ndihmësve dhe bashkëpunuesve për masakrën e Tivarit, të ndodhur në fund marsi - fillim prilli të vitit 1945;

b) hetimi i plotë i ngjarjeve që paraprinë masakrën e Tivarit dhe roli i individëve të përfshirë në secilën prej tyre;

c) zbardhja e plotë e së vërtetës historike për masakrën e Tivarit të vitit 1945 dhe nxjerrja e përgjegjësi shtetërore dhe individuale e personave që me veprimet apo mosveprimet e tyre kontribuan, lejuan dhe ndihmuan në kryerjen e saj;

ç) hetimi i plotë i fakteve dhe dokumentacionit të qëndrimit të shtetit shqiptar në vitet 1945-1990 në lidhje me këtë masakër, i përpjekjeve për zbardhjen dhe/ose fshehjen e së vërtetës për të dhe roli i strukturave shtetërore dhe individëve të kohës në raport me të.

III. Komisioni hetimor parlamentar përbëhet nga 13 deputetë. Kryetari i përket Partisë Demokratike. Përbërja e komisionit është si më poshtë:

1.	Fatos Beja	Kryetar	(PD)
2.	_____	Zëvendëskryetar	(PS)
3.	Mesila Doda	Anëtare	(PD)
4.	Viktor Gumi	Anëtar	(PD)
5.	Gent Strazimiri	Anëtar	(PD)
6.	Fatos Hoxha	Anëtar	(PD)
7.	Adriana Gjonaj	Anëtare	(PD)
8.	Gjergji Papa	Anëtar	(PD)
9.	_____	Anëtar	(PS)
10.	_____	Anëtar	(PS)
11.	_____	Anëtar	(PS)
12.	_____	Anëtar	(PS)
13.	_____	Anëtar	(PS)

IV. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 12-mujor nga miratimi i këtij vendimi.

V. Ngarkohen Kryetarja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm të krijojnë kushtet e nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të këtij komisioni.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.46, datë 15.7.2010

PËR MOSDHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E ZOTIT
VEXHI MUÇMATAJ ANËTAR I GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 136 pika 1 të Kushtetutës, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr. 6581, datë 25.5.2010,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Mosdhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Vexhi Muçmataj anëtar i Gjykatës së Lartë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr.6558, datë 13.5.2010

PËR EMËRIMIN E ANËTARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Në mbështetje të neneve 93 dhe 125, pika 1, të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Neni 1

Znj. Altina Xhoxhaj emërohet anëtare e Gjykatës Kushtetuese.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6559, datë 13.5.2010

PËR EMËRIMIN E ANËTARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Në mbështetje të neneve 93 dhe 125, pika 1, të Kushtetutës

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Bashkim Dedja emërohet anëtar i Gjykatës Kushtetuese.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6579, datë 25.5.2010

PËR EMËRIMIN E ANËTARIT TË GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të neneve 93 dhe 136, pika 1, të Kushtetutës së Shqipërisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Medi Bici emërohet anëtar i Gjykatës së Lartë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.465, datë 2.6.2010

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SPITALIT USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të vendimit nr.357, datë 18.7.2002 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien e statusit “Spital Universitar”, Spitalit Ushtarak Qendror”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e Spitalit Ushtarak Qendror Universitar”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT
TË SPITALIT USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR SUQU

PJESA E PARË
PARIME TË PËRGJITHSHME
KREU I

1. HYRJE

Spitali Ushtarak Qendror Universitar (SUQU) është institucion kombëtar shëndetësor i Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë (RSH) që siguron ndihmën mjekësore të specializuar për efektivat e Forcave të Armatosura (FA), të strukturave që parashikon statusi i ushtarakut dhe për popullsinë civile, për problemet e politraumës.

SUQU është institucion publik shëndetësor që përmbush misionin në mbështetjen shëndetësore të FA-së, si dhe trajtimin e politraumës në nivel kombëtar që nga viti 1993 e konfirmuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.357, datë 13.7.2002, ku Spitalit Ushtarak Qendror i jepet statusi "Spital Universitar" dhe emërtohet "Spitali Ushtarak Qendror Universitar" (SUQU).

2. Objekti i rregullore

Kjo rregullore përcakton drejtimit dhe parimet themelore të veprimtarisë së institucionit, bën ndarjen në mënyrë të përcaktuar të përgjegjësive, detyrimeve dhe problemeve që rrjedhin në zbatimin praktik të urdhrave dhe udhëzimeve të strukturave eprore për Drejtorinë e Përgjithshme të Spitalit, administratën dhe shërbimet mjekësore.

Gjithashtu ajo përcakton në mënyrë funksionale detyrat dhe të drejtat e strukturave ndërsptalore, të personelit dhe përcakton mundësitë për veprimtari të pavarur mjekësore, kërkimore, shkencore, teknike dhe financiare.

Elementet e saj shërbejnë për strukturat vartëse dhe të gjitha hallkat e shërbimit si udhëzues për të njohur dhe kuptuar aktet ligjore, detyrimet dhe të drejtat funksionale për rritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor.

Rregullorja harmonizon marrëdhëniet organizative dhe pedagogjike ndërmjet strukturave përbërëse dhe shërbimeve mjekësore të SUQU-së.

Rregullon marrëdhëniet didaktike ndërmjet Spitalit Ushtarak Qendror Universitar dhe Fakultetit të Mjekësisë.

3. Misioni

SUQU është institucioni më i lartë, diagnostikues, mjekues, parandalues dhe trajnues, për mjekësinë ushtarake.

Ai siguron mbështetje mjekësore të FA-së në rol 3, dhe trajnon, përgatit personelin mjekësor ushtarak për rolin 1 dhe 2 të ndihmës mjekësore, parandalimin e sëmundjeve dhe epidemive, riaftësimin e forcave në kohe paqe, konflikte e krize dhe menaxhimin e politraumës në nivel kombëtar.

Në bashkëpunim me shërbimet shëndetësore civile, ofron ndihmë mjekësore për popullatën në katastrofa e fatkeqësi. Në këtë kuadër ai synon të ketë në përbërje të tij një staf 40% civil dhe 60% ushtarak.

4. Varësia

1. Spitali Ushtarak Qendror Universitar është në varësi direkte të Ministrisë së Mbrojtjes dhe bashkërendon veprimtarinë funksionale me Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit e Shkencës dhe Rektoratin e Universitetit të Tiranës.

2. Në situata operacionale luftarake në kohë paqeje apo lufte, drejtimi e komandimi i Spitalit Ushtarak Qendror Universitar bëhet nga autoritetet ushtarake sipas akteve të nxjerra nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.

SUQU mban numrin kodik dhe atë luftarak sipas përcaktimit të autoriteteve ushtarake.

3. Drejtoria e Përgjithshme e SUQU-së drejton, organizon dhe kontrollon veprimtarinë e strukturave vartëse, Spitalit Ushtarak, Qendrës Kombëtare të Traumatologjisë dhe IKMU-së. Drejtoria e Përgjithshme e SUQU-së zbaton politikat shëndetësore të Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

5. Detyrat e SUQU-së

SUQU, si institucion i lartë diagnostikues, mjekues dhe shkencor, realizon këto detyra:

5.1 Trajtimin mjekësor të specializuar të personelit ushtarak aktiv dhe në rezervë, apo në pension, familjeve të këtyre ushtarakeve, dhe punonjësve civil në FA.

5.2 Trajtimin mjekësor të specializuar në nivel kombëtar për shërbimet e politraumës.

5.3 Mjekësinë parandaluese në FA të RSH nëpërmjet studimit dhe përpunimit të masave për parandalimin e sëmundjeve dhe të mbrojtjes shëndetësore të efektivave ushtarakë nga faktorët fizikë, kimikë dhe biologjikë.

5.4 Studimin, përpunimin dhe botimin e doktrinave, manualeve dhe materialeve të tjera për mbështetjen shëndetësore, në funksion të edukimit shëndetësor të efektivave, personelit shëndetësor në FA.

5.5 Përgatitjen pedagogjike për formimin e studentëve të mjekësisë, të mjekeve specializantë si dhe të personelit shëndetësor në FA.

5.6 Veprimtari studimore, kërkimore dhe shkencore në fushën e mjekësisë ushtarake.

5.7 Mbështetjen shëndetësore të veprimtarive operacionale të FA-së, në operacionet humanitare, në fatkeqësi, katastrofa natyrore dhe krizave nga konfliktet.

KREU II

1. Ndërtimi organizativ dhe funksionet kryesore të SUQU-së

1.1 Funksionet kryesore drejtuese të SUQU-së janë si më poshtë:

1. Drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së,
2. Bordi tekniko-administrativ (BTA),
3. Nëndrejtori mjekimit/ Kryetar i Komisionit Ushtarak Mjekësor,
4. Nëndrejtori administratës/shërbimeve,
5. Drejtori i Spitalit Ushtarak (SU)
6. Drejtori i Institutit të Kërkimeve Mjekësore Ushtarake (IKMU),
7. Drejtori i Qendrës Kombëtare të Traumës (QKT),
8. Kryeinfermieri i Përgjithshëm.

2. Kompetencat e emërimit dhe shkarkimit nga detyra

2.1 Kryeministri emëron dhe shkarkon nga detyra drejtorin e Përgjithshëm të SUQU-së me propozim të Ministrisë së Mbrojtjes.

2.2 Ministri i Mbrojtjes emëron dhe shkarkon nga detyra me propozim të Bordit Tekniko-Administrativ:

- Nëndrejtorin e mjekimit/Kryetar i Komisionit Ushtarak Mjekësor,
- Nëndrejtorin e administratës/shërbimeve,
- Drejtorin e Spitalit Ushtarak,
- Drejtorin e Institutit të Kërkimeve Mjekësore Ushtarake,
- Drejtorin e Qendrës Kombëtare të Traumatologjisë,
- Kryeinfermierin e Përgjithshëm,
- Shefat e shërbimeve,
- Shefin e shërbimit ambulator,
- Personelin ushtarak dhe personelin e lartë civil.

2.3 Drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së emëron dhe shkarkon nga detyra personelin e ulët civil, mjekësor dhe jomjekësor.

PJESA E DYTË FUNKSIONET E LARTA TË DREJTIMIT

KREU I

1. Drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së

1.1 Është epror për të gjithë personelin e spitalit dhe ka varësi direkte nga Ministri i Mbrojtjes.

1.2 Ka përgjegjësi kryesore për realizimin e detyrave që ka spitali në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore, urdhrat dhe udhëzimet e Ministrisë së Mbrojtjes, kërkesat e rregulloreve ushtarake, rekomandimet teknike të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ato të karakterit pedagogjik të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

1.3 Është mjek ushtarak dhe komandant i spitalit, me gradën “Kolonel” ose “Gjeneral Brigade”.

1.4 Ai përfaqëson spitalin si person juridik dhe është titullari ekzekutiv, drejtues, organizues dhe kontrollues i të gjithë aktivitetit të spitalit.

1.5 Në varësi direkt të tij janë nëndrejtori i mjekimit dhe kryetari i KUM-it, nëndrejtori i administratës/shërbimeve, drejtori i SU-së, drejtori i IKMU-së, drejtori i QKT-së, kryeinfermierja e përgjithshme, shefi i sekretarisë sekrete dhe specialisti i sigurisë, shefi i zyrës dhe këshilltari ligjor, shefi i personelit, shefi i financës dhe shefi i farmacisë.

1.6 Organizon dhe drejton mbledhjet e stafit të tij dhe strukturave të tjera të spitalit.

1.7 Organizon, drejton dhe analizon të gjitha problemet ekonomiko-financiare të spitalit.

1.8 Organizon kontrole vetëm dhe me grupe pune për aktivitetin e shërbimeve mjekësore dhe jo mjekësore dhe merr vendimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes.

1.9 Krijon komisionet e ndryshme funksionale të spitalit, mjekësore dhe administrative.

1.10 Ndjek realizimin e treguesve ekonomiko-financiarë të spitalit.

1.11 Mban lidhje institucionale me Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, si dhe donatorëve të ndryshëm civilë dhe ushtarakë.

1.12 Merr masa administrative për shkelje të Kodit të Punës, kontratës së punës dhe rregulloreve të shërbimit.

1.13 Nënshkruan kontratën e punës për punonjësit civilë mjekësorë dhe jo mjekësorë të spitalit.

1.14 Nënshkruan të gjitha aktet që angazhojnë spitalin ndaj subjekteve apo personave juridikë.

1.15 Deleton kompetenca administrative dhe tekniko-organizative tek vartësit e tij.

1.16 Raporton me shkrim dhe me gojë sa herë që i kërkohet tek Ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.

1.17 Shqyrton propozimet e drejtorëve të strukturave të SUQU-së dhe i propozon BTA-së emërimet, transferimet dhe shkarkimet e të gjithë personelit të SUQU-së.

KREU II

1. Bordi tekniko-administrativ

1.1 BTA është organi më i lartë i drejtimit në SUQU. Mënyra e funksionimit të tij do të bëhet sipas dispozitave të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

1.2 Përbërja e tij është si më poshtë:

- Drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së,
- Drejtori i Inspektoratit Shëndetësor në SHPPFA,
- Drejtori i Politikave dhe Planifikimit të Burimeve Njerëzore në MM,
- Mjek civil me gradë shkencore,
- Mjek ushtarak me gradë shkencore.

1.3 Mjeku civil me gradë shkencore në përbërje të BTA-së caktohet me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të SUQU-së dhe me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

1.4 Mjeku ushtarak me gradë shkencore në përbërje të BTA-së caktohet me propozim të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

1.5 BTA miraton politikat dhe strategjitë e SUQU, harton programet tekniko-financiare për planet afat shkurtër, afat mesme dhe afat gjatë në përputhje me politikat shtetërore, e shëndetësore të miratuara nga Qeveria.

1.6 Propozon strukturën e organizimit të përgjithshëm të SUQU-së.

1.7 Miraton projektbuxhetin, bilancin, veprimtarinë financiare dhe programin e veprimtarive mjekësore.

1.8 Propozon planin e modernizimit të SUQU-së.

1.9 BTA mbledhet jo më pak se katër herë në vit.

1.10 Mbledhjet zhvillohen dhe me kërkesë të Ministrit të Mbrojtjes apo Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së si dhe me kërkesën e shkruar të gjysmës së anëtarëve të BTA.

KREU III

1. Nëndrejtori i mjekimit / kryetar i KUM-it

1.1 Është mjek ushtarak me gradën “Nënkolonel” dhe titull shkencor.

1.2 Varet nga drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së.

1.3 Organizon dhe drejton të gjitha problemet teknike të shërbimeve shëndetësore të spitalit, si konsulta, analiza tekniko-shkencore, stafet mjekësore, analizat e vdekjeve.

1.4 Ndjek kualifikimin dhe ngritjen tekniko-shkencore të personelit mjekësor, së bashku me shefat e shërbimeve.

1.5 Organizon studime mbi sëmundshmërinë, vdekshmërinë dhe përcakton masat për parandalimin e tyre.

1.6 Ndjek realizimin e treguesve të spitalit dhe shfrytëzimin e kapacitetit.

1.7 Organizon sesione dhe konferenca shkencore.

1.8 Përgjigjet për koordinimin dhe bashkërendimin e punës midis shërbimeve dhe njësisve të ndryshme të shërbimit dhe drejtorisë së përgjithshme.

1.9 Në mungesë të drejtorit të Përgjithshëm, merr kompetencat organizative dhe tekniko-profesionale.

1.10 Raporton me shkrim dhe me gojë sa herë që i kërkohet tek drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së.

KREU IV

1. Nëndrejtori i administratës/shërbimeve

1.1 Nëndrejtori Administratës/Shërbimeve varet nga drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së dhe përgjigjet për shërbimet mbështetëse të SUQU-së.

1.2 Ai organizon, drejton dhe kontrollon të gjithë veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit duke mbajtur përgjegjësi për funksionimin e kësaj veprimtarie sipas legjislacionit në fuqi.

1.3 Organizon dhe drejton punën duke bashkërenduar hallkat që ka në varësi dhe shefat e shërbimeve për evidentimin dhe specifikimin e nevojave materiale për funksionimin e institucionit dhe realizimin e tyre në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik.

1.4 Nëndrejtori i administratës/shërbimeve caktohet nga drejtori i Përgjithshëm kryetar i komisionit të vlerësimit të ofertave. Ai në bazë të urdhërprokurimeve të firmosura nga drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së, drejton zhvillimin e tenderave në përputhje me legjislacionin në fuqi.

1.5 Ai organizon dhe drejton punën për administrimin e gjithë vlerave materiale, bazuar në legjisllacionin në fuqi.

1.6 Analizon dhe kontrollon çdo muaj realizimin e shpenzimeve të fondeve të planifikuara dhe ecurinë e shërbimeve nëpërmjet raportimeve që bëjnë degët përkatëse dhe veprimtarinë ekonomiko-financiare me administratën dhe këto të dhëna ia raporton drejtorit të Përgjithshëm të SUQU-së me shkrim.

1.7 Analizon çdo muaj të gjithë veprimtarinë ekonomiko-financiare me administratën dhe shefat e shërbimeve.

1.8 Analizon çdo 3 muaj gjendjen e mallrave që dalin jashtë përdorimit sipas normativave të miratuara dhe bën propozimet përkatëse pranë drejtorit të Përgjithshëm për të marrë vendimet sipas legjisllacionit në fuqi.

1.9 Analizon gjendjen e mallrave mbi normativa dhe me qarkullim të ngadalshëm dhe merr masa për normalizimin e tyre nëse ka të tilla.

1.10 Organizon dhe drejton administrimin e ndihmave nga donatorë apo organizma të ndryshëm, si dhe vendosjen e dokumentacionit për qarkullimin e vlerave materiale në të gjitha hallkat e shërbimit spitalor.

1.11 Në bashkëpunim me drejtorin e Përgjithshëm të SUQU-së ndjek zbatimin e detyrave në fushën e investimeve në shkallë institucioni.

1.12 Ndjek e analizon herë pas here mirëmbajtjen dhe riparimin e institucionit nëpërmjet degës së logjistikës dhe mbrojtjes nga zjarri.

1.13 I propozon drejtorit të Përgjithshëm të marrë masa disiplinore, të bëjë zhdëmtimin material e monetar ose kallëzimin e veprave penale për ata punonjës të institucionit të cilët thyejnë disiplinën e punës dhe dëmtojnë pronën e institucionit.

1.14 Raporton me shkrim dhe me gojë sa herë që i kërkohet tek drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së.

KREU V

1. Spitali Ushtarak (SU)

1.1 Spitali Ushtarak është institucioni kryesor shëndetësor i FA-së i cili siguron ndihmë mjekësore të specializuar të ushtarakëve, aktivë, në rezervë e pension, personelit civil të FA-së, si dhe familjarëve të tyre.

1.2 Spitali Ushtarak, nëpërmjet komisioneve mjekësore të specializuara, të përcaktuara në “Rregulloren e vlerësimit të aftësive fizike e shëndetësore të shtetasit dhe ushtarakut të FA-së”, përcakton aftësitë fizike dhe shëndetësore për kandidatët për shkollat ushtarake, për oficerët, nënoficerët, ushtarët profesionistë në FA dhe kontingjenteve që shkojnë me mision jashtë vendit.

1.3 Spitali Ushtarak është bazë pedagogjike për formimin e studentëve të mjekësisë, mjekëve specialistë, si dhe krijon kushte për mbrojtjen e gradave shkencore.

1.4 SU koordinon edukimin në vijueshmëri të mjekëve dhe personelit tjetër mjekësor në FA.

1.5 SU me personelin e tij siguron mbështetje mjekësore të aktiviteteve operacionale të FA-së.

1.6 SU koordinon veprimtarinë mjekësore të specializuar me shërbimet shëndetësore dhe qendrat mjekësore stacionare dhe fushore në FA.

1.7 SU trajton dhe popullatën civile për patologji të veçanta, me interes klinik e terapeutik, në bazë të udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ISKSH-së dhe në përputhje me urdhrat e udhëzimet e Ministrit të Mbrojtjes.

2. Drejtori i Spitalit Ushtarak

2.1 Është mjek ushtarak me gradën “Nënkolonel” ose “Kolonel” dhe titull shkencor, epror për personelin e spitalit dhe komandant për ushtarakët që ka në vartësi.

2.2 Ka varësi të drejtpërdrejtë nga drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së.

2.3 Përgjigjet për realizimin e detyrave funksionale, akteve ligjore e nënligjore, urdhrave dhe udhëzimeve, rregullores ushtarake dhe rekomandimeve teknike të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ato të karakterit pedagogjik të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

2.4 Harton programin vjetor të punës, i cili miratohet nga drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së.

2.5 Analizon veprimtarinë e treguesve teknike, ekonomike dhe financiare të spitalit dhe konkluzionet i raporton me shkrim te drejtori i Përgjithshëm të SUQU-së.

2.6 Organizon kontrolle me tematika të ndryshme në strukturat vartëse dhe merr masa administrative, teknike dhe ekonomike ndaj shkeljeve.

2.7 Nxit dhe organizon veprimtari studimore shkencore, konferenca, seminare dhe publikime shkencore.

2.8 Propozon aktivitete tekniko-konsultative dhe programet e veprimtarisë së tyre.

2.9 Harton planin vjetor të nevojave të SU në barna, pajisje e modernizim dhe e paraqet për miratim te drejtori Përgjithshëm i SUQU-së.

2.10 Raporton me shkrim dhe me gojë sa herë që i kërkohet, si dhe bën propozimet për emërimet, transferimet dhe shkarkimet e shefave të shërbimeve dhe kuadrove specialistë mjekë dhe infermier tek drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së.

KREU VI

1. Instituti i Kërkimeve Mjekësore Ushtarake (IKMU)

1.1 Instituti i Kërkimeve Mjekësore Ushtarake përmbush misionin e Spitalit Ushtarak Qendror Universitar (SUQU), në mjekësinë parandaluese si institucioni më i lartë kërkimor dhe shkencor i specializuar dhe referencë në mjekësinë parandaluese në sigurimin shëndetësor të Forcave të Armatosura (FA).

1.2 IKMU mbulon këto fusha të veprimit: mjekësisë parandaluese (higjienë, epidemiologji, dhe Inspektorat Sanitar Shtetëror-ISSH) edukim e përgatitje shëndetësore, shërbimin e mbrojtjes nukleare, survejimin statistikor dhe kartotekën e SUQU-së, mjekësinë e aviacionit dhe të marinës.

2. Detyrat bazë

2.1 Koordinimi dhe drejtimi i punës me shërbimet vartëse për planëzimin, organizimin drejtimin, që synon mbrojtjen e shëndetit, kërkimi shkencor i problemeve shëndetësore të komunitetit ushtarak për kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve e ngjarjeve shëndetësore të FA-së, si dhe aktivitetin e Inspektoratit Sanitar Shtetëror (ISSH), në zbatim të ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi.

2.2 IKMU, në bashkëpunim me strukturat shëndetësore të njësisve dhe reparteve ushtarake, ndjek dhe mban nën kontroll problemet e sëmundshmërinë infektive, treguesit higjienë-epidemiologjik në parandalimin e epidemive, zbatimin e normave higjieno-sanitare për sigurinë e ujit të pijshëm, sigurinë ushqimore, ndotjen e ambientit (fizike, kimike e biologjike) dhe organizimin e analizave e studimeve statistikore mbi efektet negative për komunitetin ushtarak.

2.3 Përpunon rekomandimet dhe udhëzimet, si dhe ndjek vaksinimin profilaktik dhe me indikacion epidemiologjik dhe certifikimin për ushtarakët në FA dhe kontingjentet me mision jashtë vendit sipas standardeve dhe rekomandimeve të NATO-OBSH.

2.4 Merr masa parandaluese për eliminimin e sëmundjeve të zoonozave dhe të efekteve dëmtoese të produkteve ushqimore me origjinë shtazore.

2.5 IKMU është baza e aktiviteteve trajnuese dhe doktrinës ushtarake mjekësore për të gjithë trupën e mjekësisë ushtarake, për sigurimin e kualifikimit të tyre dhe zhvillimin e programeve të trajnimit e edukimit shëndetësor të efektivave dhe personelit shëndetësor në FA.

2.6 IKMU mban nën kontroll treguesit e gjendjes shëndetësore nëpërmjet survejimit, studimeve dhe grumbullimit të informacionit e indikatorëve shëndetësorë, për ndjekjen në vijueshmëri të shëndetit në komunitetin ushtarak.

2.7 Në kuadrin e programeve të SUQU-së, harton programe të veçanta dhe merr pjesë në procesin pedagogjik për përgatitjen e personelit mjekësor-ushtarak dhe civil të mjekëve e personelit tjetër mjekësor në FA.

2.8 Në IKMU bëhet studimi, përpunimi dhe botimi i doktrineve dhe manualeve të tjera të nevojshme për mbështetjen mjekësore të FA-së në përputhje me doktrinën e konceptet doktrinarë të miratuara.

2.9 Identifikon rreziqet që i kanosen komunitetit në kuadrin e fatkeqësive, duke koordinuar dhe planëzuar planin e ndërhyrjes në aspektin parandalues.

2.10 Organizon kontrollin dhe ekspertizën e personelit dhe kandidatëve për në Forcat Ajrore (FAj) kontrollin periodik 6-mujor dhe vjetor të personelit fluturues në strukturat e aviacionit ushtarak dhe civil, sipas marrëveshjeve të lidhura nga SUQU.

2.11 Me specialistët e mjekësisë së aviacionit dhe marinës, bën ekspertizën mjekësore dhe monitorimin e të gjitha problemeve shëndetësore në Forcat Ajrore e Detare, në bashkëpunim me shërbimet mjekësore në këto forca.

2.12 Bën studimin dhe përpunimin e masave të mbrojtjes shëndetësore gjatë përdorimit të lëndëve helmuese luftuese (LHL), lëndëve radioaktive dhe agjentëve biologjikë.

2.13 Bashkëpunon me shërbimet homologe të vendeve të NATO-s dhe partnere për këmbim përvoja e informacioni.

2.14 Përgatit buletin e IKMU-së me analizën e problemeve higjieno-epidemiologjike për problematikën në gamën e problemeve të mjekësisë parandaluese në FA bashkë me rekomandimet përkatëse.

3. Drejtori i IKMU-së

3.1 Drejtori i IKMU-së është mjek ushtarak me gradë “Nënkolonel” ose “Kolonel” dhe gradë shkencore, i specializuar në fushën e shëndetit publik.

3.2 Ai varet nga drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së dhe është ndihmësi kryesor i tij për problemet që kanë të bëjnë me mjekësinë parandaluese, doktrinën e mjekësisë ushtarake dhe përgatitjen shëndetësore të personelit mjekësor.

3.3 Drejtori i IKMU-së drejton dhe organizon gjithë veprimtarinë dhe aktivitetin e të gjithë sektorëve të IKMU-së në përputhje me detyrat funksionale që rrjedhin nga rregullorja e SUQU-së.

3.4 Koordinon punën dhe harmonizimin e veprimtarisë së institutit në raport me drejtoritë e SUQU-së, shërbimin shëndetësor në SHP dhe në të gjitha strukturat e tjera të FA-së.

3.5 Ai njih nivelin tekniko-profesional të kuadrove dhe planifikon e i propozon Ministrin të Mbrojtjes kualifikimin dhe specializimin pasuniversitar të tyre brenda dhe jashtë vendit.

3.6 I propozon bordit tekniko-administrativ emërimet, transferimet dhe shkarkimet e shefave të shërbimeve dhe kuadrove specialistë.

3.7 Organizon kontrolle vetëm dhe me grupe pune për aktivitetin e shërbimeve dhe laboratorëve të institutit.

3.8 Përgatit përshkrimin e detyrave për të gjithë personelin që ka në vartësi, të cilat i miraton drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së, si dhe bën kontrollin periodik të zbatimit të tyre.

3.9 Raporton me shkrim dhe me gojë sa herë që i kërkohet, si dhe bën propozimet për emërimet, transferimet dhe shkarkimet e shefave të shërbimeve dhe kuadrove specialistë mjekë dhe infermier tek drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së.

4. Shërbimi i edukimit shëndetësor dhe doktrinës

4.1 Është përgjegjës në përgatitjen e programeve dhe manualeve për përgatitjen shëndetësore bazë në FA, organizimin e punës për realizimin e informim-edukim-këshillimit të komunitetit ushtarak për problemet shëndetësore, udhëzimeve dhe rregulloreve që synojnë mbrojtjen e shëndetit në FA.

4.2 Bën studimin, përpunimin dhe botimin e doktrineve, manualeve dhe materialeve të tjera të nevojshme për mbështetjen shëndetësore në FA në përputhje me doktrinën dhe konceptet doktrinare të miratuara.

4.3 Organizon, drejton, përgatit, arsimon dhe kualifikon personelin shëndetësor dhe efektivat ushtarakë me njohuritë e nevojshme për realizimin e detyrave të mbështetjes shëndetësore.

4.4 Mbikëqyr konceptet bazë të organizimit të mbështetjes shëndetësore, veprimtarinë trajnuese dhe stërvitjet e efektive ushtarakë, si dhe nivelet e tjera shëndetësore në repartet ushtarake.

4.5 Organizon seminare dhe kurse për ngritjen profesionale dhe kualifikimin e personelit shëndetësor.

4.6 Bashkëpunon me Qendrën e Doktrineve të Botimeve dhe Shtypit, për shqyrtimin e botimit e manualeve e materialeve të tjera për mbështetjen shëndetësore.

5. Shërbimi i higjienës

5.1 Është përgjegjës dhe ndjek të gjitha detyrat që lidhen me shërbimin e higjienës në FA, sigurinë e ujit, ushqimeve dhe dietave, në bazë të legjislationit në fuqi, trajnimin e personelit vartës dhe zbatimin e detyrave si Inspektor Sanitar Shtetëror në FA.

5.2 Ndjek zbatimin e ligjit “Për inspektoratin sanitar” dhe ligjit “Për ushqimin” në FA.

5.3 Ndjek survejancën epidemiologjike, inteligjencën mjekësore dhe detyrat që lidhen me shërbimin e parandalimit, sëmundjet ngjitëse në FA.

5.4 Bën organizimin dhe ndjekjen e imunizimit, ndërmerr masat sanitaro-higjienike dhe antiepidemike, si dhe bën certifikimin e kontingjenteve ushtarake që shkojnë me mision jashtë vendit lidhur me parandalimin e sëmundjeve infektive e të transmetueshme.

5.5 Organizon kryerjen e analizave fiziko-kimike e toksikologjike në produktet ushqimore, ujin e pijshëm, derdhjet industriale dhe të ajrit në mjediset e punës dhe të banimit në FA.

5.6 Organizon punën e laboratorëve dhe problematikën që lidhet me sigurinë e ujit, ushqimeve dhe problemeve të mjedisit në FA.

5.7 Organizon kontrollin për vlerësimin e dietave, kalorive dhe vlerave ushqyese të ushqimit të ushtarakëve në kushte të ndryshme stërvitjeje, shërbimi dhe pune.

5.8 Nxjerr konkluzione dhe përgatit rekomandimet për përmirësimin e strukturës ushqimore dhe të regjimit të ushqimit.

5.9 Evidenton dhe ndjek ecurinë e nivelit higjienik në FA përfshi dhe SUQU.

5.10 Ndjek, studion, evidenton burimet e furnizimit me ujë të pijshëm në FA dhe përpunon udhëzime për mënyrën e administrimit të tyre.

5.11 Organizon dhe drejton realizimin e analizave të mikrobiologjisë sanitare në ushqime, ujë dhe ajër.

5.12 Organizon dhe ndjek të gjitha detyrat që lidhen me shërbimin bërthamor, biologjik dhe kimik (NBC) në FA, në aspektin e koordinimit, informimit, përpilimit e masave dhe udhëzimeve, si dhe në aspektin shëndetësor dhe trajtimin mjekësor të të dëmtuarve.

5.13 Në bashkëpunim me shërbimin e ushqimit në Drejtorinë e Logjistikës (J4) në MM, përpilon dietat grup sipas nozologjive të sëmundjeve, si dhe në përcaktimin e vlerave e kalorive, kalkulimeve që lidhen me ushqimin në FA.

5.14 Përpunon të dhënat statistikore për nivelin higjienik në FA.

6. Shërbimi iurvejimit statistikor

6.1 Është përgjegjës për organizimin e punës në shërbimin eurvejimit statistikor dhe arkivues për grumbullimin, hedhjen dhe përpunimin e të dhënave dhe treguesve të shëndetit të komunitetit ushtarak.

6.2 Organizon punë në shërbimin e statistikës dhe arkivës së SUQU-IKMU.

6.3 Vendos programet për përpunimin e të dhënave shëndetësore dhe treguesve të shëndetit në SUQU dhe FA.

6.4 Organizon trajnimin e personelit për përpunimin në limitet e përcaktuara të të dhënave mjekësore dhe i vendos ato në dispozicion të drejtuesve dhe atyre që lidhen me këtë aktivitet.

6.5 Bashkëpunon me shërbimet homologe në INSTAT dhe Ministrinë e Shëndetësisë për unifikimin dhe koordinimin në fushën e të dhënave statistikore në shërbimin shëndetësor në FA.

7. Shërbimi i mjekësisë së aviacionit dhe marinës

7.1 Është përgjegjës për organizimin e punës dhe përpunimin e rregullave dhe udhëzimeve për kontrollin dhe studimin e treguesve fiziologjikë të personelit fluturues të Forcave Ajrore, konform STANAG-eve dhe rregullave ndërkombëtare të aeronautikës.

7.2 Organizon punën dhe përpunon rregulla e udhëzimeve për kontrollin dhe studimin e treguesve fiziologjikë të personelit zhytës (nënujës) të Forcave Detare, konform STANAG-eve të zhytjeve dhe rregullave ndërkombëtare të mjekësisë marine.

7.3 Përpunon kriteret e veprimtarisë së shërbimit të mjekësisë së aviacionit dhe marinës konform STANAG-eve për personelin fluturues dhe zhytës.

7.4 Organizon kontrollin periodik 6-mujor dhe vjetor të personelit fluturues në strukturat e aviacionit ushtarak dhe civil sipas marrëveshjeve të SUQU me shërbimet e aviacionit civil në vend.

7.5 Organizon kontrollin periodik fizik e shëndetësor vjetor në bazë të specialitetit dhe vendos për aftësitë në zhytje dhe lundrim të efektivit zhytës dhe lundrues.

7.6 Ndjek hospitalizimin e efektivit fluturues, efektivit zhytës dhe lundrues, si dhe konsultat e zgjeruara që kërkojnë vlerësim të aftësisë për fluturim, lundrim dhe zhytje.

KREU VII

1. Qendra kombëtare e traumës (QKT)

1.1 Është institucioni shëndetësor i specializuar i kujdesit mjekësor tretësor, ku trajtohen të sëmurët që kanë nevojë për shërbimet e ortopedisë dhe traumatologjisë.

- 1.2 Është institucioni kryesor universitar, mjekësor dhe shkencor për sistemin e traumës në vendin tonë.
- 1.3 Zbaton strategjinë dhe detyrat e Programit Kombëtar të Traumës.
- 1.4 Bashkërendon veprimtarinë ndërmjet sistemit të urgjencës dhe të traumës.
- 1.5 Studion dhe përgjithëson protokollet, kriteret dhe standardet për traumën.
- 1.6 Studion nevojat, standardet dhe normat më të domosdoshme për personel, pajisje, aparatura dhe materiale ndihmëse për traumën.
2. Drejtori i qendrës kombëtare të traumës
 - 2.1 Është mjek specialist ushtarak me gradën “Nënkolonel” ose “Kolonel” dhe me gradë shkencore.
 - 2.2 Ka varësi të drejtpërdrejtë nga drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së.
 - 2.3 Drejton, organizon dhe kontrollon veprimtarinë teknike, mjekësore, pedagogjike dhe shkencore të sistemit të traumës.
 - 2.4 Përgjigjet për realizimin dhe zbatimin e detyrave funksionale, akteve ligjore e nënligjore, urdhrave dhe udhëzimeve, rregulloren e institucionit dhe rekomandimeve teknike të Ministrisë së Shëndetësisë dhe atyre pedagogjike të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
 - 2.5 Harton programin vjetor të punës, i cili miratohet nga drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së.
 - 2.6 Analizon veprimtarinë e treguesve tekniko-ekonomikë dhe financiarë të Qendrës dhe konkluzionet i raporton me shkrim tek drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së.
 - 2.7 Organizon kontrole me tematika të ndryshme në strukturat vartëse dhe merr masa administrative, teknike dhe ekonomike ndaj shkelësve.
 - 2.8 Nxit dhe organizon veprimtari studimore shkencore, konferenca, seminare dhe publikime shkencore.
 - 2.9 I propozon drejtorit të Përgjithshëm të SUQU-së miratimin e komisioneve tekniko-konsultative dhe programeve të veprimtarisë së tyre.
 - 2.10 Harton planin vjetor të nevojave të QKT-së në barna, pajisje e modernizim dhe e paraqet për miratim tek drejtori Përgjithshëm i SUQU-së.
 - 2.11 Zbaton politikat dhe strategjinë mbi traumën, të përcaktuara nga Komiteti Kombëtar i Traumës.
 - 2.12 Kontrollon zbatimin e kriterëve, protokolleve dhe standardeve të traumës.
 - 2.13 Raporton me shkrim dhe me gojë, sa herë që i kërkohet, si dhe bën propozimet për emërimet, transferimet dhe shkarkimet e shefave të shërbimeve dhe kuadrove specialistë mjekë dhe infermierë tek drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së.

KREU VIII

1. Kryeinfermieri i përgjithshëm
 - 1.1 Kryeinfermieri i përgjithshëm drejton punën e kryeinfermierëve të shërbimeve, si dhe të personelit tjetër mjekësor.
 - 1.2 Siguron udhëheqje profesionale në infermieristikë për të gjithë shërbimin spitalor që mbulon.
 - 1.3 Zhvillon misionin dhe objektivat e kujdesit infermier në shërbimin spitalor.
 - 1.4 Ka përgjegjësi direkt për të propozuar ndryshimet kryesore organizative të shërbimit infermieror.
 - 1.5 Drejton dhe organizon kualifikimin e personelit infermier dhe ndihmës të shërbimit spitalor.
 - 1.6 Organizon praktikën e studentëve të infermierisë.
 - 1.7 I propozon drejtorit të Përgjithshëm lëvizjet e infermierëve brenda spitalit.
 - 1.8 Bashkëpunon me Urdhrin e Infermierit për të zhvilluar dhe mbështetur iniciativat e të gjithë institucionit duke integruar objektivat e të gjithë shërbimit infermieror dhe objektivat e përgjithshme të shërbimit spitalor.
 - 1.9 Zhvillon dhe mban një sistem komunikimi efektiv nëpërmjet të cilit jep propozimet e duhura tek drejtori i Përgjithshëm.
 - 1.10 Jep kontributin profesional në shqyrtimin e ankesave dhe çështjeve disiplinore.
 - 1.11 Harton, zbaton dhe kontrollon standardet e cilësisë së shërbimeve për të gjithë kujdesin direkt ndaj pacientit dhe shërbimeve ndihmëse.

- 1.12 Ndjek edukimin në vazhdueshmëri të personelit infermieristik.
- 1.13 Raporton me shkrim dhe me gojë sa herë që i kërkohet tek drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së.

PJESA E TRETË FUNKSIONE E SHËRBIME TË TJERA

KREU I

1. Shefi i shërbimit

1.1 Njësia e organizimit të SUQU-së është shërbimi, i cili drejtohet nga shefi i shërbimit që është mjek ushtarak me gradën “Major” ose “Nënkolonel”, me gradë shkencore dhe stazh pune mbi 15 vjet.

1.2 Shefi i shërbimit siguron udhëheqjen e shërbimit, organizon funksionimin teknik dhe administrativ.

1.3 Shefi i shërbimit varet nga drejtori respektiv.

1.4 Shefi i shërbimit punon për zbatimin e strategjisë dhe politikës shëndetësore në shërbimin që drejton.

1.5 Ai bën propozime BTA-së për emërim dhe largim nga puna sipas nevojave për personelin mjekësor, infermior dhe për atë ndihmës në varësi të tij duke respektuar procedurat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

1.6 Punon në bazë të programeve vjetore e mujore me miratim të drejtorit respektiv dhe organizon, drejton dhe kontrollon nivelin kualifikues të personelit mjek dhe infermier sipas një plani të veçantë.

1.7 Kontrollon kartelat e të sëmurëve, nivelin e diagnozës, mjekimit, ndjek dhe merr masa përkatëse për rregullimin e gjendjes kur ka shkelje ose parregullsi.

1.8 Çdo ditë bën vizitë të përbashkët me mjekët vartës dhe jep udhëzimet e nevojshme për të sëmurët.

1.9 Ndjek realizimin e treguesve të punës sipas specifikës së shërbimit, përpunon dhe bën studime statistikore.

1.10 Organizon analizat e vdekjeve dhe i dokumenton ato, jep konkluzione, përcakton masat kur është e nevojshme, organizon diskutimin e diskordancave me dokumentacionin përkatës dhe kur e sheh të nevojshme, e shtron në stafin drejtues të spitalit.

1.11 Koordinon planifikimin e shtrimeve në shërbim nëpërmjet stafit.

1.12 Bashkëpunon me shërbimet ekonomiko-teknike për nevojat që ka shërbimi.

2. Shefi i shërbimit ambulator

2.1 Shefi i shërbimit ambulator është mjek ushtarak me gradën “Major” ose “Nënkolonel” me stazh pune mbi 10 vjet.

2.2 Ai varet nga drejtori respektiv sipas strukturës së SUQU-së.

2.3 Shefi i shërbimit ambulator është përgjegjësi kryesor i organizmit dhe drejtimit të punës në të gjitha aspektet.

2.4 Ai është përgjegjës për regjistrimin dhe informatizimin e të sëmurëve ambulatorë, ekzaminimin e tyre, kontrollin dhe menaxhimin e komisioneve, si dhe ndjekjen dhe zbatimin e protokolleve në këtë shërbim.

2.5 Shefi i shërbimit ambulator harton programin e punës dhe ia paraqet për miratim drejtorit përkatës.

2.6 Ndhmon dhe kontrollon mjekët vartës në punën e përditshme sipas rregullave të miratuara në shërbimin ambulator, si dhe kontrollon dhe korrigjon dokumentacionin e vartësve të vetë që i paraqitet për miratim.

2.7 Është nënkryetar i KUM-it për jashtë shtetit dhe mban dokumentacion ligjor për këtë komision, si dhe është përgjegjës për komisionimin dhe aftësinë shëndetësore të të gjithë ushtarakëve aktivë dhe kandidatëve për ushtarakë.

2.8 Me anë të kryeinfermieres së shërbimit, drejton punën e personelit të mesëm edhe të atij ndihmës.

2.9 Shefi i shërbimit ambulator është përgjegjës për debistimin dhe kontrollin ambulator në bashkëpunim me shërbimet e tjera hospitaliere.

2.10 Kontrollon dhe raporton në drejtori sipas vartësisë për infrastrukturën dhe pajisjet e shërbimit ambulator.

2.11 Shefi i shërbimit siguron udhëheqjen e shërbimit, organizon funksionimin teknik dhe administrativ.

2.12 Punon në bazë të programeve vjetore e mujore me miratim të drejtorit respektiv dhe organizon, drejton dhe kontrollon nivelin kualifikues të personelit mjek dhe infermier sipas një plani të veçantë.

KREU II

1. Mjeku koordinator

1.1 Detyrën e mjekut koordinator (PGD) e kryejnë mjekët ushtarakë të SUQU-së ose mjekët ushtarakë nga repartet e FA.

1.2 Ai varet nga drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së e në mungesë të tij nga nëndrejtori i mjekimit/kryetari i KUM-it.

1.3 Nga mjeku koordinator varet i gjithë personeli i shërbimit 24 orësh në SUQU pas orarit zyrtar.

1.4 Ai përgjigjet për organizimin e drejtimin e të gjithë ekipit mjekësor të shërbimit 24 orësh, mban lidhje të ngushta me instancat eprore në Ministrinë Mbrojtjes, dhe me mjekët primarë të shërbimit 24 orësh.

1.5 Për marrjen dhe dhënien në kohe të urdhrave, fonogrameve, situatave dhe detyrave.

1.6 Për njohjen e gjendjes në SUQU dhe dhënien e informacionit brenda një kohe të shkurtër.

1.7 Për njohjen dhe zbatimin e rregullave të gatishmërisë në SUQU.

1.8 Ai ka për detyrë të njohë kërkesat e rregulloreve, instruksionet, rregullat e ngritjes në kushtrim dhe dokumentet e shërbimit të SUQU-së.

1.9 Të ndjekë dhe të kërkojë zbatimin e urdhrave, detyrave, udhëzimeve që jepen gjatë shërbimit 24 orësh nga drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së.

1.10 Të raportojë me shkrim tek drejtori i Përgjithshëm i SUQU çdo ditë në orën 08:00 mbas dorëzimit të shërbimit sipas formularëve përkatës mbi aktivitetin e shërbimit 24 orësh.

1.11 Në detyrën e tij 24-orëshe të shërbimit, mjeku koordinator (PGD) zbaton të gjitha kërkesat e rregulloreve bazë të shërbimit në FA.

1.12 Në rast të ngjarjeve të jashtëzakonshme që mund të ndodhin, për personalitet e larta shtetërore që mund të vijnë në SUQU, njofton menjëherë drejtorin e Përgjithshëm të SUQU e në mungesë të tij nëndrejtorin e mjekimit.

2. Mjeku kurues

2.1 Mjeku kurues ushtron aktivitetin me kohë të plotë në njësi, në fushën mjekësore, diagnostikuese, mjekuese, mësimdhënie e kërkime shkencore dhe varet nga shefi i shërbimit.

2.2 Viziton çdo ditë të sëmurët që ka në ngarkim dhe përgjigjet për organizimin e shërbimit mjekësor ndaj tyre.

2.3 Plotëson me cilësi dokumentacionin klinik.

2.4 Zhvillon informimin dhe edukimin shëndetësor në të sëmurët e tij.

2.5 Përgjigjet për veprimtarinë diagnostikuese dhe mjekuese për të sëmurët e tij.

2.6 Mjekët kurues, përfshi dhe ata që kanë aktivitet pedagogjik, kanë të njëjtat detyra dhe përgjegjësi.

3. Mjeku primar i shërbimit 24 orësh të urgjencës së politraumës

3.1 Mjeku primar i shërbimit 24 orësh caktohet me grafik mujor të aprovuar nga nëndrejtori i mjekimit dhe drejtorët respektivë, dhe miratohet nga drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së.

3.2 Ka stazh pune mbi 15 vjet, është specialist kirurg i përgjithshëm dhe zotëron aftësi teknike të larta.

3.3 Është në vartësi të mjekut koordinator mbas orarit zyrtar dhe i raporton atij për çdo ngjarje të jashtëzakonshme.

3.4 Ka në varësi ekipin e shërbimit 24 orë të përbërë nga personeli i lartë dhe i mesëm.

- 3.5 Merr e dorëzon shërbimin me dokumentacion të saktë.
- 3.6 Në momentin e marrjes së shërbimit njihet dhe zgjidh çdo problem në shërbimin e urgjencës dhe merr masa për zgjidhjen sa më shpejt të tyre.
- 3.7 Ai ka për detyrë të njohë gjendjen e të sëmurëve në shërbime, duke evidentuar me relacion të sëmurët rëndë të raportuar nga këto shërbime.
- 3.8 Në krye të ekipit të shërbimit kontrollojnë të sëmurët dhe bën shënimet në kartelën klinike të tyre sipas orarit të vizitave që aplikon.
- 3.9 Është në krye të ekipit të shërbimit për t'iu përgjigjur çdo situatë të urgjencave gjatë shërbimit 24 orë.
- 3.10 Organizon konsulta urgjente për çdo rast të rëndë që paraqitet në shërbimin e urgjencës dhe kërkon ekipe ndihmëse dhe specialistë të ndryshëm në varësi të situatës.
- 3.11 Përgjigjet për dokumentacionin mjekësor dhe jomjekësor, për ruajtjen e rregullit dhe disiplinës, të higjienës, si dhe kontrollojnë gjendjen e nevojave për medikamente e bazë materiale.
- 3.12 Zbaton protokollet shkencore me korrektësi dhe kontrollojnë aplikimin e tyre nga personeli i lartë dhe i mesëm.
4. Mjeku vullnetar
- 4.1 Mjeku vullnetar merret në shërbim me propozimin e shefit të shërbimit. Pas aprovimit në KMS, drejtorja merr vendimin e pranimit.
- 4.2 Mjeku vullnetar është jashtë organikës së shërbimit. Ai është nën varësinë e shefit të shërbimit dhe atij të klinikës, të cilët kanë përgjegjësi ligjore për çdo akt apo procedurë që mjeku vullnetar kryen.
- 4.3 Të drejtën për mjek vullnetar e kanë mjekët që kanë fituar konkursin dhe nuk është arritur t'u hapen vende në shërbime, si dhe mjekët e kualifikuar që gjykohej se mund të ushtrojnë profesionin në SUQU.
- 4.4 Mjeku vullnetar duhet të jete anëtar i Urdhrit të Mjekut.
- 4.5 Mjeku vullnetar ka të drejtë të bëjë roje në shërbim, të ndjekë të sëmurët së bashku me mjekun kurues dhe të kryejë ato akte që shefi i shërbimit gjykon se është i aftë të kryejë.
- 4.6 Mjeku vullnetar ka të drejtë të marrë pjesë në të gjithë aktivitetin e klinikës, si në staf, në mbledhje klinike në mëngjes, në diskutime dosjesh etj.
- 4.7 Shefi i shërbimit ka të drejtë që pas një periudhe pune të mjekut vullnetar në shërbimin apo klinikë, ta propozojë si kandidat për vendet e punës që hapen në SUQU.
- 4.8 Në qoftë se shefi i shërbimit apo i klinikës e gjykon se ky mjek vullnetar është i aftë të bëjë roje në shërbim, ai mund të bëjë roje të pavarur.
- 4.9 Mjeku vullnetar është përgjegjës ligjërisht për çdo vendim që ai merr.
- 4.10 Shefi i shërbimit ka të drejtë t'i propozojë drejtorit të Përgjithshëm të SUQU-së ndërprerjen e kontratës për mjekun vullnetar.
5. Mjeku specializant
- 5.1 Mjeku specializant ndjek dhe angazhohet në të gjitha veprimtaritë diagnostikuese mjekësore dhe shkencore që zhvillohen në njësinë ku ai specializohet.
- 5.2 Zbaton me korrektësi programin e specializimit.

KREU III

1. Kryeinfermieri i shërbimit
- 1.1 Kryeinfermieri i shërbimit është personi i diplomuar për infermieri dhe drejton personelin e mesëm mjekësor.
- 1.2 Kryeinfermieri i shërbimit varet nga shefi i shërbimit dhe për probleme tekniko-administrative e menaxhuese, nga kryeinfermieri i përgjithshëm i SUQU.
- 1.3 Bashkëpunon me administratën për problemet e menaxhimit të shërbimit.
- 1.4 Propozon qarkullimin e infermierëve të shërbimit me miratim të shefit të shërbimit dhe kryeinfermierit të përgjithshëm të SUQU-së.
- 1.5 Kontrollojnë aktivitetin e shërbimit 24-orësh.
- 1.6 Kontrollojnë gjendjen higjieno-sanitare të të sëmurit dhe të shërbimit, protokollet e mjekimit dhe të kujdesit infermieristik ndaj të sëmurit.

- 1.7 Njeh me detyrat e punësimit në shërbim punonjësit e rinj.
- 1.8 Ndjek edukimin në vazhdimësi të personelit infermieristik.
- 1.9 Bën vlerësimin etik dhe profesional të personelit infermieristik çdo vit dhe i dorëzon në dosjet personale në seksionin e personelit.
- 1.10 Me miratim të shefit të shërbimit dhe të kryeinfermierit të përgjithshëm, bën propozimin e argumentuar tek BTA për largim nga shërbimi për personelin infermieristik.
- 2 . Infermieri
- 2.1 Infermieri varet nga kryeinfermieri i shërbimit dhe zbaton urdhrat e tij, të mjekut kurues, të mjekut të shërbimit 24 orësh dhe shefit të shërbimit.
- 2.2 Aplikon manipulimet e ndryshme, siguron marrjen e analizave në kohë, shpërndarjen e ilaçeve dhe kontrollon zbatimin e dietave të ushqimit për çdo të sëmurë.
- 2.3 Përgjigjet për ruajtjen e rregullit, qetësisë, pastërtisë e higjienës në shërbim, sipas rregullores së brendshme të institucionit.
- 2.4 Sterilizon mjetet e punës, ruan dokumentacionin klinik dhe inventarin që ka në ngarkim.
- 2.5 Punon vazhdimisht për ruajtjen e figurës etiko-profesionale dhe paraqitjen e jashtme.
- 2.6 Rregullon çdo ditë shtratin e të sëmurit, kujdeset për zbatimin e kërkesave të higjienës personale tek të sëmuret dhe merr masat e nevojshme kur këto nuk përputhen me kërkesat e rregullores së brendshme të institucionit.
- 2.7 Kryen vazhdimisht asistencën, mbikëqyrjen dhe shoqërimin për nevojat e ndryshme të të sëmurëve.
- 2.8 Bën dorëzimin në rregull të shërbimit në turn, duke shënuar në dokumentacion të rregullt problemet që ka pasur gjatë turnit, si dhe dokumenton dhe dorëzon medikamentet që do t'i aplikohen të sëmurit në turnin pasardhës.
- 2.9 Punon vazhdimisht për ngritjen tekniko-profesionale të tij sipas programeve të aprovuara më parë.

KREU IV

1. Shërbimi VIP
- 2.1 Është shërbim special në varësi të drejtpërdrejtë të drejtorit të Përgjithshëm të SUQU-së.
- 2.2 Shefi i shërbimit është mjek ushtarak me gradën “Major” ose “Nënkolonel”.
- 2.3 Të sëmurët që trajtohen në këtë shërbim kanë statusin e mëposhtëm:
- Ushtarakët me gradën “Nënkolonel”, “Kolonel”, “Gjeneral” dhe civilët ekuivalent që shërbejnë në FA;
 - Ushtarakët e huaj me status të veçantë;
 - Trupi diplomatik;
 - Deputetë dhe qeveritarë.
- 2.4 Shtrimet në këtë shërbim bëhen me staf mjekësor me miratimin e drejtorit të Përgjithshëm të SUQU-së.
- 2.5 Ruajtja dhe siguria në këtë shërbim bëhet me urdhër të veçantë të drejtorit të Përgjithshëm të SUQU-së.

KREU V

1. Seksioni i financës
- Seksioni i financës ushtron veprimtarinë e tij duke u bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale, monetare, mbi statistikën, mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe mbi menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.
- 1.1 Dega e financës mban përgjegjësi për veprimtarinë ekonomiko-financiare të shërbimit spitalor dhe përgjigjet për përdorimin e fondeve buxhetore sipas planit të miratuar dhe destinacionet përkatëse, për zbatimin e ligjeve për lëvizjen e qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare në të gjitha hallkat e shërbimit.
- 1.2 Rakordon me degën e thesarit mbi buxhetin e vënë në dispozicion dhe ndjek veprimet e likuidimeve me bankën.

1.3 Ndjek zbatimin e përdorimin e fondeve dhe të të ardhurave dytësore sipas dispozitave në fuqi.

1.4 Kontrollon nëse blerjet janë kryer sipas dispozitave në fuqi.

1.5 Kontrollon dhe mban dokumentacionin e nevojshëm të plotë dhe të saktë mbi shpenzimet e ndryshme, si dhe qarkullimin e vlerave monetare dhe materiale, mban evidencën kontabël për pasqyrimin e saktë, në kohën e duhur, të gjitha ndryshimet që vërtetohen në bilancin financiar të spitalit.

1.6 Ndjek e kontrollon realizimin e fondit të pagave sipas planit të buxhetit, duke zbatuar vendimet në fuqi.

1.7 Kjo degë çdo dy javë i jep informacion nëndrejtorit administrativ mbi shpenzimet e evidentuara, si dhe harton situacionin mujor, duke propozuar detyrat për të ardhmen.

1.8 Nxjerr bilancet 4-mujore dhe përgatit bilancin vjetor sipas ligjit mbi kontabilitetin për institucionet buxhetore, si dhe analizon e nxjerr konkluzione mbi të dhe detyrimisht informon drejtorin e Përgjithshëm.

1.9 Në bashkëpunim me nëndrejtorin e administratës, kryen analiza ekonomiko-financiare periodike për çdo katër muaj dhe merr masa për zbatimin e detyrave të caktuara, kontrollon përgatitjen e dokumentacionit që merret me lëvizjen e vlerave materiale dhe monetare në të gjitha hallkat e institucionit sipas vendimeve në fuqi, si dhe përpunon të dhënat të cilat kanë të bëjnë me koston spitalore.

1.10 Organizon dhe drejton në mënyrë tematike, duke u mbështetur në legjislacionin përkatës, inventarët e mjeteve kryesore, të inventarit të imët dhe magazinave.

1.11 Organizon punën dhe zbaton ligjin mbi kontabilitetin për llogaritë analitike dhe sintetike, si dhe regjistrimin e tyre në dokumentet përkatëse.

1.12 Në bashkëpunim me nëndrejtorin e administratës dhe shërbimet në SUQU, ndjek lëvizjen e medikamenteve, materialeve mjekësore, reagentëve të tjerë të këtij lloji nga depo qendrore në farmacitë e shërbimeve, me qëllim moskrijimin e stoqeve të tyre.

1.13 Bën kontrole të herëpashershme të farmacive në bazë të shtrimeve, diagnozave, duke lejuar një rezerve mujore të nevojshme.

1.14 Shefi financës është anëtar i entit për përgatitjen e projektbuxhetit të ardhshëm (PBA).

KREU VI

1. Mbrojtja nga infeksionet spitalore

1.1 Në zbatim të ligjit nr.7761, datë 19.10.1993 “Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse”, të ndryshuar, dhe për të koordinuar programin e Kontrollit dhe Parandalimit të Infeksionit Spitalor në SUQU, ngrihet dhe funksionon “Komiteti për kontrollin dhe parandalimin e infeksioneve spitalore”.

1.2 Komitetit i Kontrollit të Infeksioneve Spitalore ngrihet dhe funksionon me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të SUQU.

1.3 Komiteti harton Programin e Kontrollit dhe të Parandalimit të Infeksionit, që do të përfshijë:

1.3.1 Kujdesin ndaj pacientit dhe punonjësve;

1.3.2 Ngritjen e grupeve të punës për kontrollin dhe parandalimin e infeksioneve spitalore;

1.3.3 Kontrollin e përdorimit të antibiotikëve, kontrollin e dezinfektimit dhe sterilizimit;

1.3.4 Mbikëqyrjen e aktivitetit të kontrollit të infeksionit spitalor;

1.3.5 Identifikimin e procedurave dhe proceset e shoqëruara me rrezikun e infeksionit spitalor për të zbatuar strategjitë për reduktimin e rrezikut të infeksionit;

1.3.6 Zbatimin e procedurës së larjes së duarve, përdorimin e dorezave dhe dezinfektanteve për parandalimin dhe kontrollin e infeksionit;

1.3.7 Marrjen e kulturave në mënyrë periodike nga pacientët, personeli dhe ambientet që vlerësohen me rrezik për përhapjen e infeksionit spitalor;

1.3.8 Trajnimin e personelit për organizimin në marrjen e mostrave;

1.3.9 Përcaktimin e metodave të mbledhjes së të dhënave dhe mënyra e raportimit dhe komunikimi me të gjitha njësitë e spitalit;

1.3.10 Përdorimin e të dhënave të programit të kontrollit të infeksionit, për përmirësimin e menaxhimit e cilësisë.

1.4 Planet, programet dhe mënyra e informimit për infeksionet spitalore bëhen me urdhra të brendshëm të drejtorit të Përgjithshëm të SUQU-së.

KREU VII

Kontrulli i jashtëm

Strukturat e Ministrisë së Shëndetësisë ushtrojnë inspektime dhe kontrole periodike ose me kërkesë të Ministrit të Mbrojtjes për cilësinë e shërbimit dhe përmbushjen e standardeve mjekësore në SUQU.

Përfundimet e nxjerra nga këto inspektime e kontrole i dërgohen Ministrit të Mbrojtjes dhe Ministrit të Shëndetësisë.

KREU VIII

1. Dispozita të fundit

1.1 Ngarkohet Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe drejtori i Përgjithshëm i SUQU-së të nxjerrë aktet përkatëse në zbatim të kësaj rregulloreje.

1.2 Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Spitali Ushtarak Qendror Universitar për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj rregulloreje.

VENDIM

Nr.467, datë 16.6.2010

PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË BISEDIMEVE PËR BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR VITIN 2010

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit të bisedimeve për bashkëpunimin për zhvillim, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për vitin 2010.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PROTOKOLLI

I BISEDIMEVE MBI BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, MË 18 MAJ 2010 NË TIRANË

1. Hyrje

Bisedimet mbi bashkëpunimin për zhvillim ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Federale Gjermane u zhvilluan më 18 maj 2010 në Tiranë. Delegacioni i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë u kryesua nga z.Alfred Rushaj, zëvendësministër i Financave. Delegacioni i Republikës Federale Gjermane u kryesua nga zoti Dr.Leo Kreuz. Listat e të dyja delegacioneve janë paraqitur tek anekset 1 dhe 2.

Bisedimet u hapen nga pala shqiptare, nga z.Alfred Rushaj dhe nga pala gjermane, nga i ngarkuari me punë i Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, z. Jan Rudolph.

Bisedimet u zhvilluan në atmosferën e një bashkëpunimi të hapur dhe të frytshëm. Delegacionet ranë dakord mbi bazën e rezultateve të konsultimeve paraprake të datës 9 dhjetor 2009 për përdorimin e mjeteve të disponueshme. U diskutua rreth bashkëpunimit të tanishëm dhe të ardhshëm, si dhe për tema të tjera me rëndësi.

Rezultatet e bisedimeve janë shënuar si më poshtë vijon:

2. Kuadri i bashkëpunimit për zhvillim dhe dialogu politik

2.1 Deklaratat hyrëse

Deklarata hyrëse e delegacionit shqiptar është paraqitur në aneksin 3.

Deklarata hyrëse e delegacionit gjerman është paraqitur në aneksin 4.

2.2 Kërkesat bazë dhe kushtet e bashkëpunimit për zhvillim

- Pala gjermane përshëndet përpjekjet e Qeverisë Shqiptare për dhënien e kontributit të saj në formën e pagesave të TVSH-së pa vonesa në të ardhmen dhe shpreson që çështjet ende të hapura të gjejnë zgjidhje së shpejti.

- Projektet aktuale të bashkëpunimit financiar janë renditur në aneksin 5 dhe ato të bashkëpunimit teknik në aneksin 6.

- Pala gjermane informoi që po punohet intensivisht për përfundimin e marrëveshjes së bashkëpunimit financiar të vitit 2007 për projektin “Furnizimi me ujë të pijshëm në zonat rurale”.

2.3 Përcaktimi i sektorëve kyç

Të dyja palët konfirmojnë që nëpërmjet sektorëve kyç të bashkëpunimit dypalësh për zhvillim, si energjia, zhvillimi i qëndrueshëm dhe social i ekonomisë, furnizimi me ujë, kanalizimet dhe menaxhimi i mbetjeve urbane jepet një kontribut i rëndësishëm për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013. Të dyja palët përshëndesin orientimin e dokumentit strategjik për sektorin kyç “Furnizimi me ujë të pijshëm/menaxhimi i ujërave të ndotura dhe menaxhimi i mbetjeve urbane” (shtojca 7), i cili përbën bazën e bashkëpunimit dypalësh afatmesëm deri afatgjatë në këtë sektor dhe shprehen dakord me dokumentin strategjik, drafti i të cilit i është dorëzuar palës shqiptare në kuadrin e konsultimeve qeveritare në dhjetor 2009.

Pala gjermane u shpreh se gjatë këtij viti palës shqiptare do t’i paraqiten edhe drafte të tjera të dokumenteve strategjike për sektorët kyç “Zhvillimi qëndrueshëm dhe social ekonomisë” dhe “Energjetika”.

3. Dialogu dhe miratim i bashkëpunimit dypalësh për zhvillim

3.1. Volumi i miratuar dhe rialokimet

Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë angazhohet që në periudhën 2010—2011 të vërë në dispozicion të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë një fond të ri prej 78,2 milionë euro për bashkëpunimin teknik dhe financiar dypalësh. Nga ky fond, 70,4 milionë euro planifikohen për projekte të bashkëpunimit financiar dhe 7,8 milionë euro për projekte të bashkëpunimit teknik.

Përveç kësaj, në kuadrin e bashkëpunimit financiar riprogramohen fondet e mëposhtme, në vlerën 7,4 milionë euro:

-3,4 milionë euro 2004 (vite VE) kredi me kushte IDA

nga projekti “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat rurale dhe urbane” (1998.6582.5) për projektin “Menaxhimi i mbetjeve urbane në juglindje të Shqipërisë” (2008.6517.0);

-1 milion euro 2008 (vite VE) në formë granti

nga projekti “Programi për mbrojtjen e mjedisit në Liqenin e Ohrit-menaxhimi i ujërave të ndotura Pogradec” (2008.6520.4) për projektin “Menaxhimi i mbetjeve urbane në juglindje të Shqipërisë” (2008.6517.0);

- 2 milionë euro 2008 (vite VE) në formë granti

nga projekti “Programi për mbrojtjen e mjedisit në Liqenin e Ohrit-menaxhimi i ujërave të ndotura Pogradec” (2008.6520.4) për projektin “Masterplani në sektorin e ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza” (2010.6624.0);

-1 milion euro 2008 (VE-Jahr) si kredi me kushte standarde

nga projekti “Programi për mbrojtjen e mjedisit në Liqenin e Ohrit-menaxhimi i ujërave të zeza Pogradec” (2008.6520.4) për projektin “Infrastruktura komunale II (kredi)” (2010.6631.5).

3.2 Tabelë e fondeve të miratuara, duke përfshirë dhe fondet e rialokuara

Projektet	BF/BT	Nr.projektit	Lloji	Riprog.(euro)	Miratim i ri (euro)
Korniza për projekte të tjera					
Fondi i studimeve dhe ekspertëve	BT	2002.3513.5	Shtesë fondesh		0.5 milion
Shuma e kornizës për projekte të tjera				0.00	0.5 milion
Sektori kyç i zhvillimit të qëndrueshëm e social të ekonomisë					
Efiçienca e energjisë nëpërmjet sektorit bankar	BF	2010.6622.4	Projekt i ri		12 milionë kredi e butë
Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat rurale dhe urbane, faza II	BF	2010.6571.3	Vazhdim projekti, kredi e butë		10 milionë kredi e butë
Fondi social i investimeve IV	BF	2010.6572.1	Vazhdim projekti, kredi e butë		20 milionë kredi e butë
Mbështetja për zbatimin e legjislacionit të harmonizuar me BE-në	BT	2010.2188.0	Vazhdim projekti		1 milion
Zhvillimi i integruar ekonomik dhe nxitja e punësimit	BT	2010.2087.4	Vazhdim projekti		2.4 milionë
Programi për arsimin profesional	BT	2010.2187.2	Vazhdim projekti, faza tjetër		2 milionë
Programi për arsimin profesional	BT	2008.2049.8	Shtesë fondesh		0.4 milion
Shuma në sektorin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik				0.00	47.8 milionë
Uji i pijshëm, menaxhimi i ujërave, ujërave të ndotura/mbetjeve urbane					
Menaxhimi i mbetjeve urbane në juglindje të Shqipërisë	BF	2008.6517.0	Shtesë fondesh	3,4 milionë, kushtet 0.75%, 40 vjet, 10 të përjashtuara nga principli	
Menaxhimi i mbetjeve urbane në juglindje të Shqipërisë	BF	2008.6517.0	Projekti i ri	1 milion grant	
Menaxhimi i mbetjeve urbane në juglindje të Shqipërisë	BF	2008.6517.0	Shtesë fondesh		4.4 milionë grant
Menaxhimi i mbetjeve urbane në juglindje të Shqipërisë (BM)	BF	2010.7017.6	Projekt i ri		1 milion
Infrastruktura komunale II Program (projekt investimi)	BF	2010.6570.5	Vazhdim projekti		12 milionë kredi e butë
Infrastruktura komunale II (kredi)	BF	2010.6631.5	Vazhdim projekti		1 milion, 10 të përjashtuara nga principli

Infrastruktura komunale II (kredi)	BF	2010.6631.5	Shtesë fondesh	1 milion kredi 2%, 30 vjet, 10 të përjashtuara nga principli	
Masterplani në sektorin e ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura	BF	2010.6624.0	Shtesë fondesh	2 milionë subvencion	
Programi për mbrojtjen e mjedisit në Liqenin e Ohrit – menaxhimi i ujërave të ndotura Pogradec	BF	2008.6520.4	Vazhdim projekti		10 milionë kredi (IVF)
Programi “Reforma në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizime”	BT	2010.2088.2	Projekt i ri		1.5 milionë
Shuma: Furnizimi me ujë, kanalizime dhe mbetje urbane				7.4 milionë	29.9 milionë
Shuma e përgjithshme				7.4 milionë	78.2 milionë
Shuma e përgjithshme duke përfshirë riprogramimin					85.6 milionë

3.3 Sektori kyç i energjetikës

3.3.1 Dialogu sektorial

Pala shqiptare informoi palën gjermane rreth situatës energjetike dhe reformës së zbatuar në këtë sektor. Pala gjermane përshëndeti arritjet e kryera veçanërisht në çështjet e kuadrit rregullator për mbështetjen e HEC-eve të vogla. Një vëmendje e posaçme i duhet kushtuar situatës financiare të ndërmarrjeve KESH dhe OST.

3.3.2 Bashkëpunimi financiar

Projekti i sektorit të energjetikës (Rritja e efikasitetit energjetike dhe energjitë e rinovueshme), (2004.6627.6, 2005.7009.3)

Të dyja palët përshëndesin hartimin e tre memorandumeve nga bankat partnere dhe shprehin besimin që së shpejti do të fillojë implementimi i projektit.

Pala gjermane përshëndeti realizimin me sukses të komponentit të efikasitetit të energjisë me rehabilitimin energjetik të qendrës së personave me aftësi të kufizuara “Pëllumbat” në Tiranë dhe të dy kopshteve në bashkitë e Kamzës dhe Kavajës.

Furnizimi me energji elektrike i Shqipërisë së Jugut (Bistrica I dhe II) (nr. i projektit 2003.6661.7).

Punimet për fazën e dytë të projektit (Rehabilitimi i hidrocentralit të Bistricës II, si dhe i nënstacioneve Sarandë dhe Gjirokastrë) parashikohet të përfundojnë dhe të dorëzohet në vjeshtën e vitit 2010.

Të dyja palët e përshëndesin faktin që pretendimet e ndërsjella ndërmjet KESH-it dhe konsorciumit të furnizuesve në lidhje me zhdëmtimet dhe gjobat u zgjidhën me mirëkuptim në muajin shkurt 2010.

Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri-Mali i Zi (2001.4079.8)

Projekti ndodhet në fazën e zbatimit, por për shkak të vështirësive gjatë procesit të sigurimit të truallit për ndërtimin e shtyllave, është vonuar për një vit. Pala gjermane kërkon mbështetjen e palës shqiptare për të ndihmuar partnerin OST me qëllim zgjidhjen e shpejtë të këtyre problemeve.

Linja unazore 110 kV në jug të Shqipërisë (Rritja e efikasitetit energjetike) (2006.6550.5 dhe 2008.6518.8)

Të dyja palët përshëndesin nënshkrimin e kontratave të kredisë në fillim të vitit dhe hyrjen e tyre në fuqi në muajin prill. Gjithashtu është për t'u përshëndetur dhe përgatitja e shpejtë e dokumenteve për vënien në zbatim të projektit nga ana e konsulentit. Pala shqiptare parashikon të fillojë punimet në fillim të vitit 2011.

Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri-Kosovë (Tiranë-Prishtinë) (2008.6519.6)

Të dyja palët përshëndesin nënshkrimin e marrëveshjeve të kredisë në fillimin e vitit dhe hyrjen e tyre në fuqi në muajin prill, ndërkohë që konsulenti ka filluar punën.

Potenciali hidroenergjetik dhe siguria e digave në kaskadën e lumenjve Mat dhe Drin (2009.66.531)

Pala shqiptare shpreh vlerësimin lidhur me faktin që pala gjermane në vitin 2009 ka miratuar me anën e një note verbale një kredi zhvillimi deri në 20 milionë euro për këtë projekt.

Pala gjermane tërheq vëmendjen që për marrjen e një vendimi përfundimtar në lidhje me projektet që do të financohen nga kredia e akorduar, duhen pritur rezultatet e studimit shtesë të cilat do të paraqiten në muajin tetor 2010.

3.3.3 Bashkëpunimi i ardhshëm në këtë sektor

Pala shqiptare ka shprehur interes për mbështetje në sektorët e renditur si më poshtë: transmetimi i energjisë, energjia diellore, energjia e erës, hartimin e një strategjie për energjitë e rinovueshme duke përfshirë kuadrin ligjor të efikasitetit të energjisë,

Me tej ajo sheh mundësi për bashkëpunime të mëtejshme në të ardhmen në sektorin e hidro-energjetikës. Pala gjermane nënvizon gjithashtu se në rastin e kredive të buta me fonde të KfW-së si përfitues parimisht mund të konsiderohet operatori OST, me kusht që Qeveria shqiptare të paraqesë një garanci shtetërore.

3.4 Sektori kyç i zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm e social

3.4.1 Dialogu sektorial

Pala shqiptare informoi rreth zhvillimeve aktuale në këtë sektor. Pala gjermane vlerësoi qëndrimin largpamës të Qeverisë Shqiptare dhe të Bankës Qendrore në kuadrin e krizës ekonomike globale. Qeveria shqiptare i kushton një vëmendje të veçantë mbështetjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe zhvillimit të zonave rurale, çka pasqyrohet dhe në përmbajtjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013. Pala gjermane e inkurajon palën shqiptare për të vazhduar procesin e regjistrimit të titujve të pronësisë me qëllim lehtësimin e dhënies së kredive për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në zonat rurale. Pala gjermane dhe ajo shqiptare janë të mendimit se në sektorin e arsimit profesional nevojiten reforma të mëtejshme në këndvështrimin e procesit të përafrimit me BE-në, si dhe për t'iu përgjigjur nevojës së tregut shqiptar për specialistë.

3.4.2 Bashkëpunimi financiar

Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat rurale dhe urbane, faza I, 1998.6582.5

Pasi tashmë ka përfunduar kalimi i asetëve të FEFAD tek EFSE dhe Parlamenti Shqiptar ka ratifikuar marrëveshjen e kredisë, fondet në vlerën prej 2,6 milionë euro mund të vihen menjëherë në shfrytëzim. Të dyja palët bien dakord që fondet e tjera të disponueshme në vlerën prej 3,4 milionë euro të kalojnë për zbatimin e projektit “Menaxhimi i mbetjeve urbane në juglindje të Shqipërisë” (2008.6517.0)

Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat rurale dhe urbane, faza II, 2010.6571.3

Miratim i ri i projektit, 10 milionë euro, kredi e butë, vazhdim projekti

Bazuar te përmbajtja, faza e II e projektit lidhet me mbështetjen e deritanishme në sektorin financiar. Kredimarrësit tanimë janë bankat. Projekti do të fokusohet ndër të tjera edhe në sektorin e agroindustrisë duke iu përgjigjur kërkesës së palës shqiptare dhe paraqet një hap të rëndësishëm për shtrirjen e shërbimeve financiare në sektorë deri tani të mbuluar në masë të pamjaftueshme.

Të dyja palët janë dakord që për këtë projekt të miratohet një kredi e butë në vlerën deri 10 milionë euro.

Efiçenca e energjisë nëpërmjet sektorit bankar, 2010.6622.4.

Miratim i ri i projektit 12 milionë euro, kredi e butë, projekt i ri

Ky projekt, në përputhje me Strategjinë Shqiptare për Efiçencën e Energjisë, duhet të përmirësojë situatën e kreditimit për masa që synojnë efikasitetin e energjisë nëpërmjet rifinancimit të kredive për ekonomitë shtëpiake, bizneset e vogla dhe të mesme ose komunat. Kredimarrësit tanimë janë bankat. Me anë të sensibilizimit të bankave dhe klientëve duhet nxitur kërkesa për kredi, për masa që synojnë efikasitetin e energjisë.

Të dyja palët janë dakord që për këtë projekt të vihet në dispozicion një kredi e butë në vlerën deri 12 milionë euro.

Fondi social i investimeve IV, 201065721

Miratim i ri i projektit 20 milionë euro, kredi e butë

Objektivi i projektit është të garantojë një furnizim me ujë të sigurt e cilësor brenda zonës së mbuluar nga projekti, si dhe nëpërmjet investimeve plotësuese në rrugët rurale të sigurojë një akses më të mirë në tregje dhe struktura sociale gjatë gjithë vitit.

Pala gjermane është e gatshme të vërë në dispozicion një kredi të butë me vlerë deri 20 milionë euro për fazën IV të projektit. Qeveria Shqiptare ia kalon kredinë partnerit në projekt ADF në formë granti.

3.4.3 Bashkëpunimi teknik

Mbështetja për zbatimin e legjislacionit të harmonizuar me BE-në, 2010.2188.0.

Miratim i ri i projektit, 1 milion euro

Tema e zbatimit të legjislacionit të harmonizuar me BE-në do të vazhdojë të jetë prioritet i rëndësishëm në vitet e ardhshme. Për këtë arsye të dyja palët bien dakord të parashikojnë 1 milion euro për fazën vijuese. Me këto fonde mund t'i jepet mbështetje Ministrisë së Integritimit për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe për përafrimin me legjislacionin e BE-së.

Zhvillimi i integruar ekonomik dhe nxitja e punësimit, 2010.2087.4

Miratim i ri i projektit, 2,4 milionë euro

Të dyja palët bien dakord për parashikimin e një fondi prej 2,4 milionë euro për fazën e tretë të projektit. Me fillimin e fazës së tretë, në shtator 2011, do të përfshihet edhe sektori i bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Projekti "Arsimi profesional", miratim i ri i projektit 2 milionë euro, faza vijuese 2010.2187.2

Miratim i ri i projektit 0,4 milionë euro, shtesë fondesh për fazën aktuale 2008.2049.8

Të dyja palët ranë dakord që të rritet niveli i autonomisë për Akademinë Profesionale, në Durrë, ku përfshihet administrimi i pavarur i mjeteve financiare si kusht paraprak për suksesin e Akademisë Profesionale.

Deri tani, pala gjermane ka vënë në dispozicion mjete financiare për bazën materiale të nevojshme për pjesën e praktikës në shkollat profesionale në verilindje të Shqipërisë. Ajo shpreh bindjen se në të ardhmen, pala shqiptare do të jetë në gjendje të mbulojë nevojën për materiale të shkollave profesionale.

Pala gjermane ra dakord që gjatë vitit 2010 të kryejë vlerësimin e projektit për një fazë të dytë të programit të financuar nga Fondi i Studimeve dhe Ekspertëve. Pala shqiptare shprehu rëndësinë e mbështetjes teknike për ngritjen e Qendrës së Arsimit dhe Formimit Profesional në Kamëz, për zhvillimin ekonomik dhe social të zonës. Të dyja palët theksuan se në këtë proces duhet të vlerësohet nga pikëpamja e qëndrueshmërisë edhe vazhdimi i komponentit "Akademia Profesionale e Durrësit". Të dyja palët ranë dakord të angazhohen për zbatimin me sukses të programit, si dhe të parashikojnë një shtesë fondesh me vlerë 0,4 milionë euro për fazën aktuale dhe 2 milionë euro për fazën vijuese pas vitit 2012.

3.5 Sektori kyç: Furnizimi me ujë, kanalizimet dhe mbetjet urbane

3.5.1 Dialogu sektorial

Pala shqiptare përshëndet mbështetjen e ofruar nga pala gjermane për konceptimin e masterplanit të këtij sektori, i cili do të luajë një rol vendimtar për koordinimin dhe drejtimin më të mirë të investimeve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Pala gjermane përshëndet përpjekjen për të përmirësuar jo vetëm transparencën dhe efikasitetin e përmbajtjes, por dhe atë të financimit të investimeve në këtë sektor. Të dyja palët ranë dakord, që në të ardhmen, projektet e bashkëpunimit financiar në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të konceptohen në formën e programeve, në mënyrë që t'u përgjigjen më mirë nevojave të bashkive dhe komunave duke rritur kështu fleksibilitetin në planifikim dhe eficientësinë në investime.

Të dyja palët përshëndesin zbatimin e projekteve me atë pjesë të fondeve të BE-së IPA/IPF, të cilat për Shqipërinë livrohen në bashkëpunim me KfW-në. Veç kësaj të dyja palët bëjnë përpjekje për zhvillimin e mëtejshëm strategjik të sektorit, si dhe koordinimin e kontributeve të donatoreve që veprojnë në këtë sektor përfshirë këtu dhe bashkëpunimin teknik.

3.5.2 Bashkëpunimi financiar

Masterplani në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, 2010.6624.0

Riprogramimi i 2 milionë eurove (VE 2008) në formë granti

Pala gjermane mbështet nismën e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (MPPT) për hartimin e masterplanit për sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, i cili do të shërbejë për identifikimin e nevojave për investime të ardhshme për këtë sektor, si dhe për përcaktimin e prioritetëve të ndërhyrjeve. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit konfirmoi sërish rëndësinë e këtij masterpiani për zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës, si dhe informoi palën gjermane për hapat e mëtejshëm.

Menaxhimi i mbetjeve urbane në juglindje të Shqipërisë, 2008.6517.0.

Miratim i ri 4,4 milionë euro (shtesë fondesh), riprogramim 1 milion euro (VE 2008) grant dhe 3,4 milionë euro (VE 2004) kredi (0,75%, 40 vjet, 10 vjet të përjashtuara nga principli).

Miratim i ri, 1 milionë euro, projektshoqërues 2010.7017.6,

Duke marrë parasysh përparësinë e lartë të projektit, të dyja palët janë dakord të vënë në dispozicion mjete financiare me vlerë 8,8 milionë euro në formë granti dhe një kredi me kushte IDA, si dhe 1 milion euro për një projekt shoqërues. Duke pasur parasysh edhe kontributin e Shoqërisë Rajonale për Menaxhimin e Mbetjeve në Korçë (KRWM), ky projekt financohet plotësisht me miratimet e sipërpërmendura. Meqenëse projekti i shërben drejtpërdrejt mbrojtjes së mjedisit, shëndetit dhe burimeve natyrore, si dhe përmbush objektivin e mbrojtjes rajonale të mjedisit, të dyja palët janë të mendimit se kredia duhet t'i transferohet KRWM-së në formë granti. Qeveria Shqiptare mbështet projektin mbi bazën e pritshmërisë që shoqëria do të garantojë funksionimin e qëndrueshëm të saj teknik dhe financiar.

Programi "Infrastruktura komunale I", PN 2009.6652.3

Vlerësimi nga ana e KfW-së u zhvillua në nëntor 2009. Draftkontratat janë paraqitur dhe pritet të firmosen në tremujorin e dytë të vitit 2010.

Programi "Infrastruktura komunale "Faza I" dhe "Faza II" përbën hapin e parë drejt një strukture programore të koordinuar në këtë sektor, e cila në të ardhmen do të orientohet sipas projekteve të investimit të propozuara në masterplan si dhe do të integrojë edhe kontributet e donatoreve të tjerë.

Infrastruktura komunale II: PN 2010.65705 dhe PN 2010.6631.5

Miratim i ri në formën e kredisë së butë 12 milionë euro, 1 milion euro dhe riprogramimi i 1 milion euro (VE 2008) në formën e kredisë (2%, 30 vjet, 10 vjet të përjashtuara nga principli)

Përmirësimi i situatës së furnizimit me ujë dhe kanalizimeve përbën një ndër prioritetet kryesore të Qeverisë Shqiptare. Të dyja palët ranë dakord që për këtë qëllim të miratojnë fazën e dytë të programit të infrastrukturës komunale me një kredi të butë deri në 12 milionë euro dhe një kredie me vlerë prej 2 milionë euro. Këto do të plotësohen edhe me fondet IPA të BE-së me një vlerë prej afro 23,5 milionë euro.

Masat për furnizimin me ujë, kanalizimet dhe mbetjet urbane do të zbatohen në qytetet e përzgjedhura nga pala shqiptare, si Berat-Kuçovë, Lushnjë, Kamëz, Elbasan, Fier dhe Sarandë, nëse shoqëritë përkatëse apo njësitë e pushtetit vendor përmbushin kushtet financiare dhe institucionale. Vlerësimi i programit nga ana e KfW-së është parashikuar të realizohet në tetor të vitit 2010.

Struktura e hapur e programit bën të mundur që qytete apo zona të tjera të përfshihen në një fazë të mëvonshme, sipas përcaktimit të prioritetëve të masterplanit kombëtar.

Programi për mbrojtjen e mjedisit në Liqenin e Ohrit-menaxhimi i ujërave të ndotura Pogradec, faza III, 2008.6520.4

Miratim i ri i një financimi të integruar me vlerë deri në 10 milionë euro. Të dyja palët ranë dakord për riprogramimin e fondeve me vlerë 4 milionë euro të miratuara gjatë bisedimeve qeveritare 2008, si në vijim:

- 1 milion euro në formë granti për projektin "Menaxhimi i mbetjeve urbane në juglindje të Shqipërisë" (2008.6517.0);

- 2 milionë euro në formë granti për projektin "Masterplani në sektorin e ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura" (2010.6624. 0);

- 1 milionë euro si kredi për projektin "Infrastruktura komunale II" (2010.6631.5);

duke parashikuar në vend të tyre një kredi për zhvillim të bashkëpunimit financiar me një vlerë deri në 10 milionë euro për këtë projekt. Krahas tyre ka në dispozicion edhe mjete financiare nga fondet e BE-së IPF-MW me një vlerë prej 3,5 milionë euro.

Për shkak të rëndësisë së veçantë për eliminimin e fosforit për të garantuar cilësinë e ujit në Liqenin e Ohrit, pala shqiptare shprehet e gatshme që për një periudhë afatmesme të marrë përsipër shpenzimet operative për eliminimin e fosforit, nëse partneri shqiptar në zbatimin e projektit nuk mund ta financojë vetë këtë proces. Pala shqiptare i kërkoi palës gjermane që këto shpenzime (deri në 200.000 euro/vit) të financohen nga fondet e projektit për një periudhë kalimtare deri në 5 vjet.

Programi i mbrojtjes së mjedisit të Liqenit të Shkodrës, 2002.6667.6

Sikurse ishte rënë dakord gjatë konsultimeve qeveritare në dhjetor 2009, me një shkresë të datës 19.4.2010 Qeveria Shqiptare ka paraqitur një plan veprimi, i cili përcakton hapat e mëtejshëm, përgjegjësitë dhe afatet kohore për marrjen e masave për mbrojtjen e burimit të Dobraçit.

Pala gjermane përshëndet Planin e Veprimit të paraqitur dhe rolin aktiv të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjiellës-Kanalizimeve në MPPT për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të masave. Në proces janë përfshirë edhe njësitë e pushtetit vendor Rethina, Shkodra, si dhe Zyra e Legalizimeve. Pala gjermane pret zbatimin pa vonesë të masave të parashikuara. Të dyja palët ranë dakord se këto hapa janë të nevojshëm për suksesin e projektit dhe se projekti do të ndërpritet nëse këto masa nuk zbatohen pa vonesë. Pala shqiptare u angazhua t'i paraqesë KfW-së një raport të përmuajshëm rreth statusit të zbatimit të masave të planifikuara.

3.5.3 Bashkëpunimi teknik

Reforma në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, 2010.2088.2,

Miratim i ri 1,5 milionë euro, projekt i ri

Objekti i projektit është përmirësimi i kapaciteteve institucionale, rregullatore dhe menaxhuese në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri. Në vitin 2011 programi do të bashkojë të dy projektet aktuale në fushën e konsulencës për sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve "Konsulencë për reformën e sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve" (2002.3513.5-028) dhe "Konsulencë për Entin Rregullator të Ujërave" (2008.2087.8). Veç kësaj ky program plotëson angazhimin gjerman në kuadër të bashkëpunimit financiar, si dhe kontributin e donatorëve të tjerë.

Të dyja palët bien dakord që për këtë program të parashikojnë mjete me një vlerë prej 1,5 milionë euro.

3.5.4 Bashkëpunimi i ardhshëm

Të dyja palët ranë dakord për të shqyrtuar mundësinë e një faze të mëtejshme të projektit infrastruktura komunale III.

3.6 Bashkëpunimi jashtë sektorëve kyç

3.6.1 Bashkëpunimi teknik

Fondi i Studimeve dhe Ekspertëve (SFF), 2002.3513.5

Miratim i ri 0,5 milionë euro, shtesë

Të dyja palët ranë dakord të përdorin Fondin e Studimeve dhe Ekspertëve (SFF) për projekte brenda sektorëve kyç të bashkëpunimit. Pala shqiptare dëshiron të realizojë me mbështetjen gjermane një studim për identifikimin e nevojave në infrastrukturën e tregut të produkteve bujqësore. Palës gjermane do t'i jepen në lidhje me këtë kërkesë informacione të detajuara.

Aktualisht në kuadër të këtij fondi po zbatohen projektet si në vijim:

- Mbështetje për ngritjen e seksionit për aplikimet energjetike si pjesë e Qendrës Kombëtare të Licencave.

-Mbështetja e industrive kreative.

-Konsulencë për reformën në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

3.7. Mbështetja e bashkëpunimit rajonal

3.7.1. Bashkëpunimi financiar

Rezervati ndërkufitar i Prespës, 2001 6678.5

Pala shqiptare informoi lidhur me përmbushjen e marrëveshjeve të zbatimit për çështje të buxhetit dhe personelit që së shpejti KfW-së do t'u konfirmohet me shkrim. Po kështu miratimi i draftit të kontratës së konsulencës do të realizohet së shpejti.

3.7.2 Bashkëpunimi Teknik

Fondet e hapura rajonale (FHR) për Europën Juglindore (ORF)

- FHR "Konsulencë për tregtinë e jashtme në Europën Juglindore" (7,15 milionë €)

- FHR "Modernizimi i shërbimeve bashkiake në Europën Juglindore" (5,5 milionë €)

- FHR "Konsulencë ligjore në Europën Juglindore" (6.5 milionë €)

- FHR "Shfrytëzimi efikas i energjisë në Europën Juglindore" (6 milionë €).

Aktualisht Shqipëria merr pjesë në 18 nënprojekte të Fondeve të Hapura Rajonale. Aplikimet për projekte në kuadër të tyre mund të paraqiten pranë GTZ-së si nga institucionet publike, ashtu dhe nga ato private (p.sh. dhomat e tregtisë, shoqatat, universitet etj.). Miratimi i projektpropozimeve realizohet brenda një periudhe të shkurtër. Informacione të mëtejshme mund të merren pranë zyrës së GTZ-së në Shqipëri.

3.7.3 Programet e InWEnt-it përqendrohen në sektorët e integritit evropian, reformave administrative dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Programet e forcimit të kapaciteteve janë konceptuar në baza rajonale, d.m.th. ndërmjet vendeve të Europës Juglindore. Shqipëria është një ndër vendet partnere të InWEnt-it.

4. Instrumente dhe kontribute të tjera të Bashkëpunimit Gjerman për Zhvillim

4.1 Përgatitja e projekteve në kuadër të bashkëpunimit financiar

Të dyja palët bien dakord që për përgatitjen e mbikëqyrjen e projekteve të bashkëpunimit financiar të përcaktuar gjatë këtyre bisedimeve qeveritare sipas rastit do të nevojiten studime, ekspertiza dhe ndërhyrja e specialistëve. Këto masa do të rakordohen nga KfW-ja në bashkëpunim me autoritetet kompetente. Fondet për këtë qëllim vihen në dispozicion nga qeveria federale gjermane përveç fondeve të miratuara në pikën 3.1 për bashkëpunimin financiar dypalësh. Gjatë konsultimeve ose bisedimeve të ardhshme qeveritare të dyja palët do të raportojnë në lidhje me zbatimin dhe rezultatet e aktiviteteve të zhvilluara.

4.2 Qendra për Migrim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (CIM) mbështet Shqipërinë në përpjekjet e saj për plotësimin e nevojave me specialistë në sektorë të rëndësishëm ku mungojnë specialistët vendas. Aktualisht në vend punojnë gjithsej nëntë specialistë të angazhuar pranë punëdhënësve shqiptarë. Kryesisht në sektorin e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. CIM shpreh gatishmërinë e saj për të dërguar specialistë të tjerë në përputhje me kërkesat e palës shqiptare.

4.3 Shërbimi i ekspertëve në pension (SES) dërgon ekspertë të kualifikuar për misione të shkurtra dhe të një natyre praktike. Misionet shërbejnë për zgjidhjen e problemeve të veçanta teknike apo organizative, si dhe për kualifikimin e personelit vendas në ndërmarrjet dhe institucionet shqiptare. Shërbimi SES ka edhe ekspertë të arsimit profesional të cilët mund të përdoren për kualifikimin e personelit mësimdhënës në Shqipëri.

4.4 Republika Federale kontribuon me rreth 20% të buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit Evropian e në këtë mënyrë edhe në financimin e instrumenteve të ndihmës për përaftrim (IPA), që përfiton Shqipëria.

4.5 Përveç instrumenteve aktuale të financimit të BF-së, KfW-ja për llogari të vetë mund t'u vërë në dispozicion kredi apo asistencë si institucioneve shtetërore, ashtu dhe kompanive private, kur bëhet fjalë për projekte të rëndësishme në kuadër të politikave të zhvillimit. Vëmendja kryesore u kushtohet projekteve në fushën e infrastrukturës sociale dhe ekonomike, si dhe mbështetja e sektorit financiar. Për këto fusha KfW-ja vepron me porosi të posaçme të Qeverisë Federale të Gjermanisë. Për shkak të natyrës së projekteve që duhet të financohen, përpara akordimit të një kredie asistencë, Republika e Shqipërisë pranon se është e nevojshme të vërë në dispozicion të KfW-së pa vonesa dhe në vlerë të mjaftueshme valutë për shlyerjen e borxhit (transferimi i valutës). Pala shqiptare përpigjet të përmbushë këto kërkesa brenda afateve dhe garanton se nuk do ta trajtojë KfW-në ndryshe nga se institucionet e tjera financiare multilaterale.

4.6 Delegacioni gjerman theksoi se aktualisht me mbështetjen financiare të Qeverisë Federale veprojnë në Shqipëri fondacioni Friedrich-Ebert-Stiftung, fondacioni Hanns-Seidel dhe fondacioni Konrad-Adenauer.

5. Deklarata dhe klauzola përfundimtare

5.1 Kushte për zbatimin e projekteve të bashkëpunimit financiar dhe teknik

Të dy delegacionet janë të një mendimi se të gjitha shërbimet e palës gjermane të parashikuara në këtë protokoll (në pikën 3.2) mund të realizohen vetëm pasi:

-Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë të ketë marrë një vendim pozitiv pas vlerësimit të projektit/programit nga Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Teknik (GTZ) dhe/ose nga ndonjë organizatë tjetër e ngarkuar me këtë detyrë;

-të garantohet financimi i plotë i projektit/programit;

-të kenë hyrë në fuqi marrëveshjet që duhet të lidhen sipas së drejtës ndërkombëtare (marrëveshjet qeveritare, si dhe marrëveshjet për programet/projektet), kontratat e huasë dhe marrëveshjet e zbatimit me KfW-në, GTZ-në apo organizata të tjera zbatuese.

5.2 Klauzola për skadimin dhe rialokimin e fondeve

Pala gjermane vuri në dukje se miratimet në kuadër të bashkëpunimit financiar dhe të bashkëpunimit teknik (shih pikën 3.2) shfuqizohen pa zëvendësim, nëse marrëveshja e zbatimit d.m.th., kontrata e huasë/financimit në rastin e BF-së dhe shkëmbimi i notave verbale në rastin e BT-së nuk përfundon brenda një periudhe 8-vjeçare që prej vitit të miratimit. Për miratimet e vitit 2010, ky afat

skadon më 31.12.2018. Për riprogramimin e miratimit me vlerë 4 milionë euro të vitit 2008, afati skadon më 31.12.2016.

Nëse njëri apo disa prej projekteve të përmendura nuk zbatohet ose zbatohet vetëm pjesërisht, atëherë qeveritë e të dyja vendeve mund të bien dakord për zëvendësimin e tij/e tyre nga ndonjë projekt tjetër/projekte të tjera.

Zëvendësimi i projekteve nuk mund të realizohet për projektet e bashkëpunimit financiar si në vijim:

- “Eficienca e energjisë nëpërmjet sektorit bankar” (2010.6622.4);
- “Rifinancimi i NVM-ve në zonat urbane dhe rurale”, faza II, (2010.6571.3);
- “Fondi i investimeve sociale IV” (2010.6572.1);
- “Infrastruktura komunale II” (2010.6570.5);

“Programi për mbrojtjen e mjedisit në Liqenin e Ohrit-menaxhimi ujërave të zeza Pogradec” faza III (2008.6520.4).

5.3 Deklaratë për antikorrupsionin

Të dy delegacionet janë të një mendimi në lidhje me përzgjedhjen dhe konceptimin e projekteve të bashkëpunimit sipas kriteve të rëndësishme për zhvillim.

Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshilli i Ministrave të Shqipërisë ndajnë të njëjtin vlerësim për pasojat negative të korrupsionit:

- Korrupsioni dëmton rëndë mirëqeverisjen.

- Korrupsioni shpërdoron mjetet e kufizuara financiare dhe ka pasoja të thella negative për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

- Korrupsioni rrezikon besueshmërinë e bashkëpunimit për zhvillim dhe mbështetjen e tij nga opinioni publik duke cenuar përpjekjet e të gjithë atyre që punojnë për mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

- Korrupsioni pengon konkurrueshmërinë e hapur, transparente dhe të orientuar drejt çmimit e cilësisë.

Të dyja qeveritë do të bashkëpunojnë ngushtë për të garantuar transparencën, detyrimin për të dhënë llogari dhe integritetin e përdorimit të fondeve publike, si dhe për të përjashtuar me çdo kusht mundësitë e rasteve të korrupsionit në bashkëpunimin e tyre për zhvillim.

5.4 Pala gjermane përshëndet masat e marra nga Qeveria Shqiptare për të vazhduar luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore. Ratifikimi i protokollit të Palermos, miratimi i disa ligjeve dhe akteve nënligjore kundër trafikimit të qenieve njerëzore, ngritja e Qendrës Kombëtare të Koordinimit, si dhe plani kombëtar i veprimeve, bashkëpunimi ndërkombëtar si në kuadër të Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore, ashtu dhe në kuadër të nismave të tjera rajonale konsiderohen si hapa të rëndësishëm për të luftuar me çdo kusht trafikimin e qenieve njerëzore dhe për të garantuar standardet e të drejtave të njeriut për mbrojtjen e viktimave. Qeveria Gjermane shpreson se do të vazhdojë zbatimin rigoroz të Planit Kombëtar të Veprimeve kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

6. Bisedimet e ardhshme qeveritare

Bisedimet e ardhshme për bashkëpunimin për zhvillim ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë do të zhvillohen në Tiranë në vitin 2012. Konsultimet e ardhshme do të zhvillohen në vjeshtën e vitit 2011.

7. Ky protokoll hyn në fuqi ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Republikën Federale të Gjermanisë, në rrugë diplomatike, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për miratimin dhe hyrjen e tij në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më datën 18 maj 2010, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

Për delegacionin e Këshillit të Ministrave
të Republikës së Shqipërisë
z. Alfred Rushaj

Për delegacionin e Qeverisë së Republikës Federale
të Gjermanisë
z. Leo Kreuz

VENDIM
Nr.468, datë 16.6.2010

PËR KALIMIN E NJË SIPËRFAQEJE TRUALL, PRONË SHTETËRORE, NË FONDIN E KOMPENSIMIT FIZIK DHE KOMPENSIMIN E KISHËS ORTODOKSE AUTOQEFALE, DIOQEZA KORÇË, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1532, DATË 19.11.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË KORÇË, TË QARKUT TË KORÇËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8/a të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” dhe të neneve 16 e 28 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja, truall, pronë shtetërore, prej 2200 (dy mijë e dyqind) m², e ndodhur në zonën kadastrale 8562, e përbërë nga prona me numër pasurie 2/551, si dhe pjesërisht prona me numër pasurie 2/863, në të njëjtën zonë kadastrale, sipas planit të rilevimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kalojë në fondin e kompensimit fizik dhe t'i vihet në dispozicion Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në përputhje me ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.

2. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pasi bën verifikimin përfundimtar të pronësisë së truallit, për fondin e mësipërm, e përdor atë për kompensimin e Kishës Ortodokse Autoqefale, dioqeza Korçë, sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

3. Në listën që i bashkëlidhet vendimit nr.1532, datë 19.11.2008 të Këshillit të Ministrave, hiqet prona me numër rendor 885.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Zyra Qendrore për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme dhe bashkia Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha


PLAN RILEVIMI

PERGATITI	IDENTIFIKIMI I PASURISE
EMRI Inspektorja e AKKP-se Ing. Bukurie KOKOSHI	ZONA KADASTRALE 8562
Licensa _____ Date _____	NR.I PASURISE _____ VOL _____ FQ. _____
Data e Pregatitjes 30.03.2010	INDEKSI I HARTES KO; N-9
	SHKALLA 1 : 500
	ADRESA E PASURISE Rrethi _____ Korçe
	Q/F Korçe Rr/L _____
	P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____
Vule - Firme	PRONARI I pretenduar per kompensim fizik Kisha Orthodhokse Autoqefale Dhoqeza Korçe
	<input type="checkbox"/> S=2200m ²

Konturi i prones se pretenduar per kompensim fizik me S=2200m² i hedhur sipas plan vendosjes se pergatitur nga top. i licensuar Robert P Prona qe pretendohet te kompensohet eshte pozicionuar ne hartën e vleres ne Zonen I



PLAN RILEVIMI

PERGATITI	IDENTIFIKIMI I PASURISE
EMRI <u>Inspektoria e AKKP-se Ing. Bukurie KOKOSHI</u>	ZONA KADASTRALE <u>8651</u>
Licensa _____ Date _____	NR.I PASURISE _____ VOL _____ FQ _____
Data e Pregatijes <u>30.03.2010</u>	INDEKSI I HARTES <u>KO. L-8</u>
Vule - Fime _____	SHKALLA <u>1:1000</u>
	ADRESA E PASURISE Rrethi _____ Korçe _____
	Q/F <u>Korçe</u> Rr/L _____
	P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____
	PRONARI <u>Kisha Orthodhokse Autoqefale Dhioqeza Korçe</u>

- Konturi i prones se njohur me Vendim te KKP-se Korçe nr. 1329, dt.11.01.1996
- Konturi i prones se kthyer me Vendim te KKP-se Korçe nr. 1329, dt.11.01.1996 dhe me vendim gjykate nr. 1956, dt. 16.11.

Konturi i prones qe do te kompensohet.

Prona e njohur eshte e pozicionuar ne dy zona te hartes se vleres

Zona 1 dhe Zona 2

Prona qe kerkohet te kompensohet rezulton ne harten e vleres ne Zonen 1



VENDIM
Nr.490, datë 23.6.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMEVE, NË SHKOLLËN E LARTË
UNIVERSITARE PRIVATE “LUARASI”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në shkollën e lartë universitare private “Luarasi”, Tiranë, të programit të studimit të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në “Administrim publik”.
 2. Ky program studimi i ciklit të parë realizohet me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 3 (tri) vite akademike. Në përfundim të programit të studimit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Administrim publik”.
 3. Hapjen, në shkollën e lartë universitare private “Luarasi”, Tiranë, të programeve të studimeve të ciklit të dytë, në formë e studimeve me kohë të plotë, në:
 - a) E drejtë publike e administrative;
 - b) E drejtë civile e tregtare;
 - c) E drejtë penale.
 4. Këto programe studimesh të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 (dy) vite akademike. Në përfundim të këtyre programe të studimeve lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë” (DND) në:
 - a) E drejtë publike e administrative;
 - b) E drejtë civile e tregtare;
 - c) E drejtë penale.
 5. Hapjen, në shkollën e lartë universitare private “Luarasi”, Tiranë, të programit të studimit “Master i nivelit të parë” (MNP), në formën e studimeve me kohë të plotë në “Specialist/jurist në administratën publike”.
 6. Ky program studimi realizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 1(një) vit akademik. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë” (MNP), në “Specialist/jurist në administratën publike”.
 7. Shkolla e lartë universitare private “Luarasi”, Tiranë të fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimeve, të përcaktuara në pikat 1, 3 e 5 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
 8. Ky institucion duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimeve, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.
 9. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.491, datë 23.6.2010

**PËR LICENCIMIN E SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “UNIVERSITETI ELITE”,
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e shkollës së lartë private “Universiteti Elite”, e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.
2. Shkolla e lartë private “Universiteti Elite”, Tiranë do të organizohet në dy fakultete:
 - a) Fakulteti i stomatologjisë, që do të ofrojë programin e integruar të studimit të ciklit të dytë, në “Stomatologji”.
 - b) Fakulteti ekonomik, që do të ofrojë programet e studimeve të ciklit të parë, në:
 - i) Menaxhim biznesi;
 - ii) Financë-bankë;
 - iii) Administrim publik;
 - iv) Ekonomik.
3. Shkolla e lartë private “Universiteti Elite”, Tiranë do të ofrojë programin e integruar të studimit të ciklit të dytë, me kohëzgjatje 5 (pesë) vite akademike, duke plotësuar, së paku, 300 kredite. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet “Diplomë e integruar e nivelit të dytë” (DIND) në “Stomatologji”.
4. Shkolla e lartë private “Universiteti Elite”, Tiranë do të ofrojë programet e studimeve të ciklit të parë, me kohëzgjatje 3 (tri) vite akademike dhe me plotësimin e, së paku, 180 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimeve lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në:
 - i) Menaxhim biznesi;
 - ii) Financë-bankë;
 - iii) Administrim publik;
 - iv) Ekonomik.
5. Shkolla e lartë private “Universiteti Elite”, Tiranë, ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimeve, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
7. Shkolla e lartë private “Universiteti Elite”, Tiranë, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimeve, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.
8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 26.7.2010

Doli nga shtypi më 26.7.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 36 lekë